



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Gjuhë dhe Civilizim Grek”

Kolegji Universitar “LOGOS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD Elida BEGAJ

Dr Elvis BRAMO

Shkurt /2022

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Logos”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Gjuhë dhe civilizim grek
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 433, datë 20.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha greke
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	(9+2+4) = 15
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Logos", është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 1055, datë 29.07.2009. Kolegji Universitar "Logos", zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Kolegji Universitar "Logos", ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.95, date 20.10.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2020.



Kolegji Universitar "Logos", është i organizuar në 3 fakultete, dhe 9 departamente. Fakultet në përbërje të Kolegjit janë :

1. Fakulteti Ekonomik;
2. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Bachelor në "Gjuhë dhe civilizim grek" licensuar me Urdhër Nr. 433, datë 20.07.2018. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Për të kryer vlerësimin GVJ u mbështet në RVB, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi. Qe në fillim do të donim të theksonim përpjekjen që është bërë për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, po të kemi parasysh se është përvoja e parë e këtij departamenti që mbulon këtë program studimi. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe janë bërë përpjekje që ai të pasqyrojë me vërtetësi gjendjen aktuale të cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të infrastrukturës mbështetëse. Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Rektoratit të KU Logos.

Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se ka vend ende për përmirësim, veçanërisht të në vazhdimin e këtij programi në cikline dytë dhe shtimin e numrit të studentëve. Gjithashtu hartimi i një programi studimi të përbashkët me një nga universitetet greke do të ishte plus për studentët dhe fitimin e një diplome të lëshuar nga vendet e BE. DGjCG në KU LOGOS ka në përbërje staf akademik me përvojë dhe të kualifikuar të huaj dhe vendas që i përballon shumë mirë kërkesat shkencore që shtron ky program studimi. Po kështu ka në përbërje profesorë me përvojë akademike dhe pedagogjike që janë mbështetje e madhe për promovimin e më të rinjve. GVJ-ja vërejtë se puna shkencore e stafit akademik duhet të jetë më e shtuar gjatë një viti akademik si dhe stafi duhet të përfshihet më shumë në projekte e trajnime ndërkombëtare, duke ju referuar stafit akademik shqiptar.

Sfida me e madhe që duhet të zgjidhe në të ardhmen ky departament është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Aktualisht ka vetëm 5 studentë në vitin e parë, 5 në vitin e dytë dhe 5 në vitin e tretë. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, prandaj si prej KU LOGOS, si prej fakultetit ku bën pjesë ky departament duhen hartuar politika për të rritur numrin e studentëve. Megjithëse pas zhvillimit të këtij program studimi, bachelor, studenti i ka të pakta mundësitë e punësimit DGjVC si dhe strukturat përkatëse të KU Logos duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën për këtë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” të ofruar nga Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek pranë Kolegjit Universitar “Logos”, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KU “Logos”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: PhD. Elida Begaj dhe Dr. Elvis Bramo. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. Pas trajnimit nga specialistë të ASCAL-it, GVJ u njoh me RVB dhe gjithë dokumentacionin shoqëruar të tij. Pas shqyrtimit të RVB, GVJ ishte i gatshëm për vizitën 2-ditore në KU LOGOS. Për shkak të pandemisë, vizita u shty dhe më në fund u krye në dt 25- 26 qershor, 2021.

Sipas agjendës dhe nën mbikqyrjen e specialistes së ASCAL-it, GVJ filloi takimet, së pari me dekanin e këtij fakulteti, e cila pasi bëri një paraqitje të programeve të studimit që mbulon ky fakultet, të infrastrukturës dhe stafit akademik e mbështetës, ngriti shqetësimin e numrit të pakët të studentëve, në këtë program në veçanti, dhe në gjithë fakultetin e universitetin në përgjithësi. Ai listoi një varg faktorësh objektivë duke u nisur dhe nga periudha e pandemisë prurjeve të reja dhe parashtroi objektiva dhe masat që do merren në këtë drejtim.

Pas kësaj GVJ u takua me të gjithë aktorët që krijojnë, por njëkohësisht dhe marrin cilësi, si: me grupin e hartimit të RVB, me stafin akademik, me studentët. Po kështu u vijua dhe me stafin mbështetës së realizimit të këtij program studimi, si: Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Edukimit, Sektorin e Kurrikulave, Zyrën e Shërbimit të Studentëve dhe Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Projekteve. Takimet ishin të frytshme, pyetjet objektive dhe të gjithë u treguan të gatshëm për shpjegime dhe për paraqitjen e gjendjes sa më afër realitetit. Pas kësaj u vijua me vizitën në bibliotekën e Universitetit, në ambientet e auditorëve dhe në vëzhgimin e mjeteve të nevojshme për mësim. Në përfundim GVJ kërkoi materiale dhe dokumente shtesë, të cilat na u vunë shumë shpejt në dispozicion.

Kolegji Universitar “LOGOS”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.12.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 9 / 33 Prot, datë 28.12.2021. Kolegji Universitar “LOGOS”, përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 131/1 Prot, datë 11.01.2022, “Përgjigje tuajës 9 / 33 Prot, datë 28.12.2021, lidhur me dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit”.

Lidhur me të gjitha komentet e nisura nga KU “Logos” për programin Bsc në: “Gjuhë dhe Qytetërim grek”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konsultoi të gjitha me shume kujdes, dhe arriti në përfundimin: se të gjitha këshillat dhe vërejtjet e konstatuara gjatë punës së kryer janë marrë parasysh dhe janë reflektuar nga Kolegji Univeristar LOGOS. Rrjedhimisht nuk është e nevojshme që draft raporti të pasurohet me komente të tjera, as me shtesa e ndryshime

dhe as me përmirësime. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Gjuhë dhe Civilizim Grek”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	KU LOGOS është një institucion jopublik i licensuar me VKM nr.1055 datë.29.07.2009, i cili ka për mision promovimin dhe kontributin e kërkimit shkencor në qendrat kërkimore dhe të kulturës greke në Shqipëri, por duke ngritur ura bashkëpunimi me gjuhën dhe kulturën shqipe. Në nenin 3 të Statutit të KU “LOGOS” theksohet se misioni i Kolegjit është që <i>“të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe të interesave të zhvillimit të vendit”</i> , ndërsa në po këtë nen, theksohet se <i>“traditat më të mira morale, kulturore, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, të ndërthurrura me standardet dhe arritjet më të mira ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti”</i> . Programet e studimit të ofruara nga KU LOGOS janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar dhe me Ligjin e Arsimit të Lartë. Programi Bachelor në Gjuhë dhe civilizim grek, nuk bie ndesh me nenin 57 të Kushtetues, me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2105, stausin e universitetit dhe planin strategjik viti 2018 – 2024 (Aneksi 5). Ky program synon të forcojë vlerat akademike dhe ka afri me programet e ofruara ne universitet publike të vendit tonë dhe me programet e universiteteve europiane. Progami është hapur me Urdhër. Nr. 433, datë 20.07.2018, të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, me qëllim që në përfundim të ciklit të parë të këtij program studimi, të diplomojë, mësues të gjuhës greke në institucione publike dhe jo publike, përkthyes dhe prurje cilësore në fushën e turizmit.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar një plan strategjik me qëllim përmirësimin e kurrikulave, të mësimdhenies dhe përshtajen me kërkesat e tregut. Universiteti ka hartuar një plan strategjik, të cilin departamenti e përshtat me specifikat e programit dhe në strategjinë e zhvillimit të departamentit. Vihet re që departamenti ka hartuar programin Gjuhë dhe Civilizim grek, në përputhje me me planin strategjik të universiteti. Departamenti ka hartuar një program në përputhje me planin stragjik.								
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstronjë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në statutin dhe rregulloren e institucionit përcaktohen qartë drejtimit prioritar akademike. GJV vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek “ofrohet në përputhje me drejtimit akademike të institucionit. Statuti i miratuar më 01. 04. 2019, dhe rregullorja e përgjithshme i kanë përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike. (Evidenca 1_1_Statuti i KU “LOGOS”); (Evidenca 2_Rregullorja e përgjithshme e KU “LOGOS)								
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi i këtij program është bere sipas urdhrit nr. 433, datë 20.07.2018, program që realizohet me 180 kredite, me kohë të plotë, me kohëzgjatje trevjecare, ky program ofrohet nga Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunkimi Gjuhësor të Kolegjit Universitar Logos. Departamenti ka paraqitur një relacion të fokusuar në kërkesën për të ndryshuar emërtimin nisur nga fusha specifike e studimit, Vendimit nr.21, datë 15.10.2020, i Senatit, ka ndryshuar emërtimin e departamentit nga: Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë në Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek. (Aneksi 18_Nr.2_Vendim Senati Akademik 21.)								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
--	--	--	--	---

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Program i studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” ka strukturuar dhe parashtruar objektivat kryesor në strategjinë e zhvillimit, në thelb të së cilës qëndron përgatitja e mësuesve të gjuhës, në shkolla publike dhe private, kërkues. Nisur nga sistemi arsimor shqiptar programi bachelor, nuk i jep mundësi punësimi si mësues, pa vazhduar një program të ciklit të dytë, i cili nuk mund të ndiqet në këtë institucion, por në një institucion tjetër. Programi i studimit është ende në ciklin e parë, grupi i ekspertëve konstatoi se ky program studimi ka një numër të pakët studentësh dhe një pjesë prej tyre e frekuentojnë si degë të dytë. Mendohet që këta mësues të jenë burim për shkollat fillore dhe të mesme të fondacionit” Frymë dashurie” dhe si kërkues shkencor, si guide turistike, por duke ndjekur procedurat për të pasur një program që të përballojë kërkesat dhe cilësisë që kërkon tregu.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Referuar dokumentave të dosjes së vetëvlerësimit, rezultojnë se institucioni ka kryer një studim të tregut, (<i>Aneksi 6, Plan marketingu_CP-Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>), në të cilin konstaton për një numër të konsiderueshem të rinjsh të minoritetit dhe femijë, të cilët kanë përfunduar studimet e liceut në Greqi, si burim potencial për këtë program dhe, mundësi e tyre për t’u punësuar në shkolla, guida turistike, arkivistikë, përkthim. Në KU LOGOS, funksionon edhe Zyra e Çështjeve Studentore dhe e Këshillimit të Karrierës, ku sipas rregullores (<i>Aneksi 12, Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës.</i>), ka për mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të rrisë punëshmërinë e studentëve; - të shërbejë për një përjasje më të mirë të studentëve me tregun e punës; <p>Ndërsa qëllimi i zyrës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rritja e numrit të studentëve që punësohen; - krijimi i lidhjeve me punëmarrësit potencialë;
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave</p>	<p>- të rrisë punëshmërinë e studentëve;</p> <p>- të shërbejë për një përjasje më të mirë të studentëve me tregun e punës;</p> <p>Ndërsa qëllimi i zyrës është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rritja e numrit të studentëve që punësohen; - krijimi i lidhjeve me punëmarrësit potencialë;

që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	– njohja me tregun e punës nga pikëpamja e kërkimit të punës së dëshiruar;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	KU LOGOS, pjesë e të cilit është programi Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek”, ka ndërtuar një përvojë të tijën në disa programe studimi. Ky program studimi zhvillohet për herë të parë në këtë institucion, është identifikuar si pikë e forte, stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme nga Universiteti “Arsitotel” i Greqisë, të cilët përcjellin burimet shkencore, metodikën, pedagogjinë e krijuar pas një përvoje shumë vjecare institucionale, në disa programe. Ky program studimi gërshetohet dhe kërkimin dhe turizimin. Fusha e këtij programi studimi është në përputhje me drejtimin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor. Ai është në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësisirës Europiane të Arsimit të Lartë. Programi ofohet nga Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar (Tabela, 1), Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 62 pedagogë , nga të cilët 35 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 5 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 10 kanë gradën Dr. dhe 17 Asistent Lektorë me Msc, dhe 27 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr. dhe 8 Asistent Lektorë me Msc.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet	Ndërsa Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek ka 7 pedagogë efektiv (PAE) , nga ku 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesorë të Asociuar”, 2 kanë gradën Dr dhe 3 Asistent Lektorë me Msc, dhe 9 pedagogë me kontratë

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	(PAK) nga ku 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 5 kanë gradën Dr. dhe 1 Asistent Lektorë me Msc.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5



Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Rregullimi i jetës së brendshme dhe veprimitarisë së KU “Logos”, rregullohet nëpërmjet akteve rregullatore si: Statuti, Rregullorja e Përgjithshme e KU “Logos”, Rregullore e FSHHKGJ etj. Rregullorja e Përgjithshme e KU “LOGOS” ka për qëllim rregullimin e veprimitarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Kolegjit Universitar “LOGOS” në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij.</p> <p>Për mbarëvajtjen e programit mësimor, KU LOGOS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete greke si, ‘Aristotel’, “Demokritus“ Universitetin e Maqedonisë së Jugut. Pjese e marrëveshjes është mobiliteti i stafit dhe i studentëve.</p> <p>KU LOGOS ka procedura të standartizuara për përditësimin e syllabuseve, aprovimin e literaturës etj. Departamenti ka paraqitur dhe një analizë vjetorë 2018 -2019, ku konstaton pikat e forta dhe asnjë pike e dobët te konstatuar gjatë vitit akademik. Edhe pse programi frekuentohet nga një numër i vogël studentësh, ky fakt nuk konsiderohet, në raport vjetor duke i vënë theksin cilësisë dhe jo sasi. (<i>Aneksi. 21_Raporti Vjetor i Departamentit GJCG (2019-2020)</i>).</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	<p>Për mbarëvajtjen e programit mësimor KU LOGOS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitetet greke si ‘Aristotel’, “Demokritus“ i Maqedonisë së Jugut, etj, një nga aktivitetet fryt i këtyre marrëveshjeve përcillet dhe në (<i>Aneksin 16_Nr.3_Zoto Trajnim</i>), Informacioni është i percjellë dhe në RVB</p>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimave nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Ky program e ofron kryerjen e praktikës profesionale në nivelin Bachelor. Praktika ofrohet kryesisht, në shkollat e Fondacionit “Frymë Dashurie“ në bazë të marrëveshjes (<i>Aneksi 28_Nr.2_Marrëveshja me Fondacionin Frymë Dashurie</i>).</p> <p>Ky program studimi në vitin akademik 2020 – 2021 nxjerr brezin e parë të studentëve të diplomuar. Megjithatë Institucioni ka ngritur Zyrën e Cështjeve Studentore dhe të Këshillimit të Karrierës, ku sipas rregullores së saj (<i>Aneks_12_Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës</i>) ka për mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rrisë punësimin e studentëve; • Të shërbejë për një përfaqje më të mirë të studentëve me tregun e punës; 			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Program i studimit Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” është i organizuar në module sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Lëndët janë të organizuara, në module dhe kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Cikli i parë i studimeve ka gjithsej 180 ECTS, dhe në çdo vit akademik, programi është i organizuar me 60 ECTS. Raporti i orëve individuale dhe orëve në auditor është përlllogariur bazuar në rregulloren përkatëse. Ky program studimi jep njohuri për gjuhën dhe historinë e qytetërimit grek. Praktika profesionale është pjesë e programit dhe zhvillohet nëpër shkollat e fondacionit “Frymë Dashurie”, në kërkim, përkthim (<i>praktika profesionale, tabela 40</i>). Ky program studimi është hartuar në përputhje me njohuritë akademike, në këtë fushë. Bashkëpunimi me universitetet greke për literaturën e përditësuar dhe burime njërezore i ndihmon në ndërtimin e një tradite të mirë shkencore dhe në integrimin e teorisë me praktikën.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Referuar syllabeseve në anekset përkatëse, studentët marrin njohuri në Gramatikë, Greqishten e vjetër, Histori të qytetërimit grek, Teatri etj. Priorja për organizimin e seminareve drejt produkteve praktike i ndihmon për të përvetësuar dhe për ti aftësuar studentët në problemet që mund të dalin gjatë viteve të ardhshme në profilet e tyre të punës.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM nr.41.datë 24.01.2018,” Për elementet e programeve të studimit të ofruara në institucionet e arsimit të lartë” konstatohet se, që në rregulloren e vitit 2017, janë përfshirë lëndët, module, disiplinat, kreditet, kurrikulat, organizmi i punës, format e punës, sitetmi i vlerësimit. Ky program mësimor ofrohet me 180 ECTS dhe është i përbërë nga lëndë bazë, lëndë karakterizuese ,lëndë disiplinore/integruese, lëndë plotësuese, praktika profesionale, disiplina me zgjedhje.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas (<i>Tabela_9</i>) ndarja e veprimtarive formuese nga A – E është:</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet</p>	<p>Sipas (<i>Tabela_9</i>) ndarja e veprimtarive formuese nga A – E është:</p>



që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<ul style="list-style-type: none"> • lëndë bazë ose të përgjithshme A, (33. kredite, ose 18%); • lëndë karakterizuese B (94.5 kredite, ose 53%); • lëndë ndërdisiplinore C (25.5 kredite, ose 13 %); • lëndë plotësuese D (24 kredite, ose 13 %); • detyrime përmbyllëse E (6 kredite, ose 3.%) 			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Departamenti ka të hartuar programin me plan mësimor (<i>Aneksi 13_Nr.1_Plani mesimor i programit Bsc Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>), ku ka cilësuar ngarkesat në auditor, frekuentimin dhe vlerësimin. Forma e vlerësimit për çdo student paraqitet në dispozitat e përgjithshme të rregullores së programit të studimit (<i>Aneksi 4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>) dhe, në përfundim të çdo syllbusi të pedagogut përgjegjës (<i>Aneksi 13_Nr.2_Plani mesimor dhe syllabuset e programit Bsc Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>).			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ referuar informacionit në systemin e informacionit të ASCAL, konstaton se Kolegji Universitar “Logos”, është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhrit Nr. 282, datë 04.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 95, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit me vlefshmëri deri më 19.10.2020. Programi i studimit është për herë të parë në proces akreditimi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e	Njësia kryesore bazë duhet të ketë të përcaktuar një koordinator, si personin përgjegjës për ecurinë e zhvillimit të programit dhe ndjekjen e praktikave profesionale. Ky rol është marrë përsipër nga përgjegjësi i departamentit. Duke pasur parasysh që viti akademik 2020-2021, ka qenë periudhë pandemie, praktikat profesionale, nuk janë realizuar nëpër shkollë (<i>programi i praktikës profesionale është i ngarkuar në Tabeln 40</i>) por, ka një vendim të posaçëm (<i>Aneksi nr. 19_Nr.2_Vendim për praktikë profesionale</i>). Departamenti ka

<p>tij. Koordinatorin e programit informon vazhdimisht titullarin e njësive përkatëse.</p>	<p>hartuar një plan marketingu rreth punësimit potencial të studentëve të këtij programi në disa institucione. (<i>Aneksi 6_Plan marketingu_CP-Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p><i>Programi është vetëm në fillimet e tij, dhe nëse do të kishte jetëgjatësi, mendojmë që do të ishte e nevojshme marrja e përgjegjësisë së kësaj detyre, nga një individ tjetër, për të ndjekur ecurinë dhe zbatimin e praktiva mësimore jo vetëm në shkollat e Fondacionit “Fryme Dashurie” por edhe në institucionet e përmendura, në planin e cituar më sipër.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor ka në përbërje tre departamente;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës; 2. Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë; 3. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek;
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek, ofron vetëm këtë program studimi.</p> <p>Referuar (<i>Tabela 1</i>), Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor në vitin akademik 2020 – 2021, ka në përbërje të tij 62 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 35 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 27 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është:</p> <p><u>Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 13 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 10 PAK, ndër të cilët, 5 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 15 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 8 PAK, ndër të cilët 6 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; - 9 PAK, ndër të cilët 8 me tituj / grada; <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Gjuhës dhe Civilizimit grek që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p>



	<p>Për vitin akademik 2018-2019, (5 PAE / 5 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 5;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (7 PAE/ 7 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 7;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (7 PAE / 9 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 8;</p> <p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FSHHKGJ) i, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik - organizimin dhe strukturën akademike. <p><i>Për sa i përket njësisë bazë për programin e studimit konstatohet se për vitin akademik 2018 -2019 nuk përmbushen detyrimet ligjore për numrin e personelit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se FSHHKGJ dhe DGJCG, zotërojnë informacionin e plotë lidhur me programin Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizimit Grek”, siç është plani mësimor, informacion mbi strukturën akademike, informacion mbi rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Këto informacione ju vendosën në dispozicion edhe GVJ.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar Rregullores së përgjithshme të Fakultetit (<i>Aneksi nr.3</i>) në <i>Kreun 2, 3 dhe 4,5</i> gjendet informacioni i plotë lidhur me dispozitat e përgjithshme, bazat ligjore, strukturat organizative, të dhënat për personeli akademik, format e studimit, vlerësimit, kriteret e pranimit, syllabuset e lëndëve, kriteret e pranimit të lëndëve, suplementin e diplomës etj. Në bazë të VKM 41. datë 24.01.2018. “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	

<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Institucione të Arsimit të Lartë, program i studimit është organizuar në disiplina gjuhësore, letrare. Këto disiplina janë të ndërtuara në module, të cilat organizohen brenda një semestri.</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> <p>GVJ referuar (<i>Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek, neni 5</i>), konstaton se programi ka informacion të plotë për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Referuar mouleve dhe syllabuseve të ngarkua, në sistem, vëmë re se çdo modul përben një pjesë të programit të lëndës së hartuar, në tematika që kanë rrjedhë llogjike, të ngjashme dhe të rregullta. Programet e studimit janë shoqëruar nga përgjegjësi i Departamentit edhe me planin mësimor, ku është detajuar në orë ngarkesa në auditor për çdo lëndë. Mënyra e frekuentimit dhe e shlyerjes dhe vlerësimit janë vendosur në fund të çdo sylabusi nga pedagogët përgjegjës. Bazuar në VKM përkatëse forma e studimit të këtij programi është me kohë të plotë. Ky program mësimor ofrohet me 180 ECTS dhe është i përbërë nga:</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, - Lëndë bazë, 33 ECTS; - Kategoria B, - Lëndë karakterizuese, 94.5 ECTS; - Kategoria C, - Lëndë disipline/integruese. 22.5 ECTS; - Kategoria D, - Lëndë plotësuese, 24 ECTS; - Kategoria E - Detyrime përmbyllëse, 6 ECTS
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Kjo ndarje përputhet me peshën e specifikuar sipas VKM 41. datë 24.01.2018, ku sipas së cilës 15 - 20% kategoria A, 50 - 55% kategoria B, 12 - 15 % kategoria C, 10-15% kategoria D dhe 3- 5% kategoria E. Programi i studimit që ofrohet nga DGJCV përmban informacione për studentet në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit e</p>



	<p>transferimit të studentëve, ekujalentimin e studimeve, të cilat përshkruhen në dokumnetin përkatës.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ vuri re se, studentët kishin informacion për kriteret e pranimit, (Aneksi 19, 4) transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. (Aneksi 19, 5.1).</p> <p>Referuar syllabuseve të ngarkuara, dhe komunikimeve me studentët, u konstatua se, programi i studimit Bcs në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë Në syllabuse gjendet informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Gjithashtu jepen temat dhe ka informacion për frekuentimin Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. Në fund të çdo syllabusi të ngarkuar, në anekset përkatëse është ngarkuar dhe forma e vlerësimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit mbështet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sic vihet re, ngarkesa krediteve për secilën lëndë përshtatet nga roli i tyre në program. Edhe pasi është riorganizuar programi me 17% (Aneksi 49), ndarja e krediteve është përcaktuar nga roli i secilës lëndë në program.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Programi përmban: <ul style="list-style-type: none"> - 180 Kredite, - Çdo vit ka 1500 orë në total sipas shpërndarjes më poshtë:

<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësismit profesional.</p>	<p>-Të tre vitet 600 orë në auditor /900 orë jashtë auditorit;</p> <p>Emërtimi i lëndëve mundëson aftësimin e studentëve për programet në ciklin e dytë. Duke pasur parasysh që studentët, nuk mund të vazhdojnë ciklin e dytë, në KU LOGOS, atyre u jepet mundësia që ciklin e dytë të këtij programi ta vazhdojnë në programin: Master i Shkencave në."Mësuesi në gjuhën greke për arsimin e mesëm të lartë"në Universitetin e Tiranës.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Lëndët dhe modulet në funksion të tyre krjojnë mundësinë e arritjes se objektivit kryesor në formimin e mësuesit të gjuhës greke me njohuri gjuhësore për t'u përballur me problemet e kësaj fushe. Raporti leksion-seminar duket i përballueshëm nga studentët. Natyra e kësaj dege të dijes jep njohuri të zgjeruara të karakterit deskriptiv, ka sintaksë, Drejtshkrimi, Morfologji e Sintaksë kanë karakter praktik. Po kështu në letërsi greke ka analiza e veprave letrare, analiza e tekstit. Didaktike ë gjuhës greke, Civilizim, Edukim i teatrit, mundëson gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura dhe lëndët e programit janë në përputhje me emërtimin tyre dhe me profilin e programit. Modulet kanë ngarkesë në kredite sipas rendësisë së tyre dhe specifikave në formimin e studentit. Raporti teori - praktike ka qasje në formën leksion -seminar. Studentët e ketij programi mund të kenë mobilitetet te i njëjti program studimi në Universitetin e Tiranës. ose në universitete të tjera. (<i>Aneks 19_Nr.5.1_Transferim Fakulteti mbi transferimet</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Morfologjia, Analiza e Gjuhës janë lëndë që japin njohuri praktike dhe lëndët Civilizim, apo Letërsi Antike shërbejnë për të intergruar njohuritë praktike dhe ato gjuhësore.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Ndarjet.4.5 kredite. 3 orë leksion në javë, 1.5 seminare në javë dukej e përballueshme nga studentet. Gjatë konsultimit me planin mesimor të programit u kosntatua se disa prej syllabuseve si: Leksikologji, dhe lëndë e kategorise E, nuk i kishin të ndarë kreditet javore, <i>Histroia e Qyeterimit Grek, nuk i kishte të ndarë kreditet javore dhe shpërndarjene e tyre.</i> (<i>Aneksi 13_Nr.1_Plani mesimor i programit Bsc Gjuhe dhe Civilizim Grek</i>)</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Studimi i tregut të punës, në rastin e këtij programi është hartuar një plan marketingu dhe një plan promovimi (<i>Aneksi nr.6, Aneksi 42, nr.14.</i>) për mundësinë e shtimit dhe punësimin të studentëve të këtij programi. Ky plan sjell nevojën e përmirësimit të kurrikulës. Në vitin akademik 2019 – 2020,</p>

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	është marr një iniciativë për ndryshimin e kurrikulës mësimore në masën 17%. Kjo iniciativë është përcjellë në një raport të departamentit me detajet e ilustruara (<i>Aneksi, 20</i>).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Duke u nisur dhe nga marrdhënia e ngushtë dhe shkëmbimet e stafit pedagogjik dhe burimeve të bibliotekave, bursave dhe trajnimeve, <i>GVJ rekomandon mundësinë e konceptimit të një diplome të përbashkët me universitet greke.</i> Lëndët dhe modulet mundësojnë arritjen e objektivit kryesor dhe shtimin e numrit të studentëve. Mund të ndiqet e njëjta procedurë si IAL-ë të tjera në teritorin e RSH.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Departamenti përbehet nga personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i formësuar në baze të Ligjit të Arsmi të Lartë dhe Kërkimin Shkencor 80/2015. Referuar dokumentit (<i>Tabela_2</i>) të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 16 pedagogë ndër të cilët 7 PAE dhe 9 PAK . Mbulimi i programit në përqindje është 44% PAE dhe 56% PAK . Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 14 pedagogë ndër të cilët 7 PAE dhe 7 PAK . Mbulimi i programit në përqindje është 50% PAE dhe 50% PAK . Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 10 pedagogë ndër të cilët 5 PAE dhe 5 PAK .
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e	

përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Mbulimi i programit në përqindje është **50% PAE dhe 50% PAK.**

Për sa i përket kualifikimeve të Personelit akademik:

- Për 2018-2019, 90% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 10% janë Msc;
- Për 2019-2020, 78% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 22% janë Msc;
- Për 2020-2021, 75% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 25% janë Msc.

Duke analizuar realizimin e programit mesimor, bazuar në (Tabela 4.) plani mësimor i lidhur me personelin akademik vërehet kjo përqindje e mbulimit të programit mesimor:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2018-2019	52.5 %
2019-2020	56 %
2020-2021	61%

Edhe pse Kolegji Universitar Logos, ka nënshkruar marrëveshje me MASR (PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË NJËSITË BAZË TË KOLEGJIT), (Aneks_33_Nr.2_Marrëveshje per percaktimin e numrit te personelit akademik me kohe te plote ne njesite baze_MASR), në nenin 3 pika 2, citohet (**në cdo rast personeli akademik me kohë të plotë në secilën njësi bazë duhet të mbulojë 70 %+ , të ngarkesës mësimore**).

Për sa më sipër GVJ rekomandon, që Institucioni të marrë masa për të shtuar numrin e stafit akademik efektiv që të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës së orëve në auditor, sipas kërkesave ligjore në përputhshmëri me VKM nr. 418 datë 10.05.2017.

Titullarët e lëndëve janë me titull Professor, Prof. Assoc dhe me grade shkencore. Kategorizimi i tyre bazohet në ligjet në fuqi. Lektorët janë me titull Prof. Prof, Assoc, dhe me grade shkencore. Ka dhe lektorë, të cilët, kanë diplomë të ciklit të dytë, kryesisht programe të përfunduara në universitetet greke. Asistentë Lektorët kanë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master të Shkencave dhe janë pedagogë me kohë të pjeshme,

dhe me kohë të plotë, dhe mbulojnë lëndë specifikenë programin bachelor. Stafin akademik i departamentit është një staf me përvojë në mësimdhënie.

Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda këtij institucioni është:

- a) Kategoria Profesor 140 orë mesimore, ne auditor;
- b) Kategoria Lektore 165 orë mesimore, në auditor;

Për stafin akademik të jashtëm ngarkesa është 120 orë mësimore, në auditor (është kategoria Lektor).

Fusha e kualifikimit të përgjithshëm dhe specifik është në përputhje me programin e studimit. Ka përputhje të CV-së, dhe lëndëve që zhvillojnë në auditor. Në punën e këtij departamenti vërehet edhe koordinimi midis punës së stafit me përvojë me stafin më të ri. Lëndët e formimit bazë i mbajnë pedagogë me përvojë dhe të kategorisë Profesor. Vlerësimi i performancës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme lidhet me kërkesat e performancës gjatë vitit akademik (*Aneksi 37_Nr.2_Vlerësimi i performancës së stafit, pyetësorë, sem. I, 2019-2020*).



Stafi akademik është i huaj dhe shqiptar rrjedhimisht kanë një punë shkencore intensive, me artikuj të botuar, libra dhe pjesëmarrje në konferenca. (*Aneksi 16, nr.2*). Stafin akademik është i përfshirë në aktivitete kerkimore, shkencore, trajnime, bashkëpunime me institute pedagogjike, por, secili prej tyre ka peshën dhe rëndësi sipa targetit të caktuar. Duke respektuar punën dhe aktivitetin kërkimor të të gjithë stafit do të donim të sillnim në vëmendje që bashkëpunimi me ASCAP për hartimin e pyetjeve të kualifikimit të mesuesve të AMU dhe AML, të mo listohet dhe referohet në RVB, si punim shkencorë. Referuar rastit të masc .aida zoto.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nisur edhe nga situata e jashtëzakonshme e shkaktuar nga pandemia për shkak të Covid-19, Kolegji Universitar “LOGOS” ka miratuar gjatë vitit 2020-2021 disa udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të tillë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues për mësimdhënien dhe mësimin në distancë, i ndarë për stafin akademik dhe për studentët; - Urdhër për përdorimin e platformave digjitale; <p>Gjatë dy viteve të pandemisë këto metoda, janë përdorur gjerësisht nga studentët dhe pedagogët, si pjesë e një kulture pune të nevojshme. Këto metoda interaktive janë përdorur në lëndën Fonetikë, Fonologji, Gramatikë.</p> <p><i>(Aneksi 40_10_Udhëzues ne nivel institucional per zhvillimin dhe perdorimin e motedave inovative te mesimdhënies.)</i> <i>Aneksi_40_Nr.1_EdupageStudentët;</i> <i>Aneks_40_Nr.4_Microsoft 365 Teams (shembull);</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>KU LOGOS ka në përbërjen e tij” Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe të Vlerësimit”, e cila është konceptuar, referuar dokumentit zyrtar të KU LOGOS, mbi “Politikat e Sigurimit të Cilësisë”, Vendim nr.11, viti 2011, riformatuar në vitin 2018,2020. <i>(Ankesi.38 nr 4,5)</i>. Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, në nenin 26, “Burime dhe Instrumente të Vlerësimit të Brendshëm”, Pika 1.d, cilëson si vlerësim të brendshëm, “vlerësimin e kolegëve, të studentëve dhe drejtuesve”. Nga komunikimi me stafin akademikGVJ u informuam se, çdo semestër organizohet një pyetësor me studentët, me stafin akademik, i cili strukturohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Pyetësori përmban në strukturën e tij, pyetje rreth punës së stafit akademik, mendimin e kolegëve në kriteret përcaktuara, dhe mendimin e shefit të deaprtamentit për punën secilit prej titullarëve të lëndëve. Një formular i plotësuar është referuar <i>(Aneksi 37. Nr.2, “Vlerësimi i përfomancës së stafit” dhe “Paketa e instrumenteve të NJSBC” Aneksi 38, nr.8)</i>. Sipas raportit të paraqitur nga</p>



	<p>NJSCB për vitin 2019,(<i>Aneksin 38. Nr.1</i>). për vitin 2019 nuk rezultonte asnjë verejtje. Ndërsa në RVB është vendosur edhe pyetëtori me përgjigjet e studentëve për programin e Mësuesisë për semestrin e parë,2019 – 2020. (<i>Aneksi 37.2</i>). në qasjen tonë, i panevosjshëm. Pyetëtori për programin GJCG ishte strukturuar mbi qëllimin, metodologjinë, vlerësimin, komunikimin, ndërveprimin. Pyetëtori përmbante dhe një formular të vecantë për cilësinë dhe efektivitetin e metodave të mësimdhënies gjatë pandemisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të komunikojë dhe me studentët, të cilët konfirmuan cilësinë e mësimdhënies dhe komunikimit edhe pse pjesa më e madhe e tyre, e ndiqnin si fakultet të dytë dhe kishin një përvojë të mëparshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>E drejta e çdo studenti për t'u ankuar ndaj rezultatit përfundimtar të provimit, parashikohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rregulloren e Kolegjit Universitar “LOGOS” (<i>nenet 116, 118, 122</i>). – Rregulloren e Programit të Studimit (<i>neni 14</i>). <p>Në këto nene saktësohet e gjithë procedura që duhet të ndiqet prej ankimit deri në dhënien përfundimtare të përgjigjes.</p> <p>Pyetëtori “Mbi Cilësinë e Mësimdhënies”, shihet nga stafi si një nga mënyrat e përfshirjes së studentëve në vlerësim, prandaj ndërmeren gjithmonë masa për përmirësimin e këtij pyetëtori dhe reflektimi mbi përfundimet e nxjerra prej tij.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC është struktra përgjegjëse jo vetëm për sigurimin e cilësisë por edhe për bërjen publike të këtyre rezultateve. Në përfundim të përpunimit të pyetëtorit ajo harton një raport, i cili paraqet problematikat dhe reflektimet. Siç i kemi referuar të gjitha këto informacione janë bërë publike në raportin e NJSCB. (<i>Aneksi 37_Nr.1_Raport nga NJSBC per rezultatet_22 07 2019</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni harton një raport vjetor lidhur me anketimet e kryera. (<i>Aneksi 35, 1, 2, 3</i>). Në raportin vjetor midis të tjerave merret në shqyrtim edhe pyetëtori me rezultatet e tij. Gjatë bisedës konstatoam që të gjithë studentët ndiheshin të motivuar. Raporti i NJSBC “Mbi vlerësimin pyetësorëve të departamenteve dhe pedagogëve viti 2018-2019”, paraqet një situatë pozitive për punën e pedagogëve, citojmë: “Një përmirësim të ndjeshëm në punën e këtij departamenti dhe vlerësim pozitiv për pedagogët” (<i>Aneksin 38. Nr 9</i>)</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Shkencat Humane, pjesë së cilës është edhe ky program kanë si formë të tyre transmetimn e dijeve dhe njohurive në fomatin e mësimdhënies, i cili organizohet në leksione seminare, punë me projekte, punë e pavarur, praktika profesionale. Për arsye pandemie forma klasike, leksione e seminare është kryer online. Ky process është monitoruar për mbarvajtjen dhe realizimin nga strukturat përkatëse (<i>"Monitorimi i Aktiviteteve të Microsoftit"</i>, <i>Aneksi 40, nr.6</i>).është hartuar dhe një rregullore e provimeve online (<i>Aneksi, 32.</i>).Praktikat profesionale e studentëve të këtij departamenti duhet të kryhej pranë AMU-vë dhe AML-ve, të Fondacionit "Frymë Dashurie", por për arsye pandemie, këto praktika, nuk u arritën të zhvilloheshin dhe janë përshtatur në forma të tjera, në KU LOGOS (<i>Aneksi 19, nr.2</i>). Departamenti në qasjene e tij ofron mundësinë e leksioneve të hapuara, si formë e miratuar nga insntitucioni si p.sh. me Prof Emeritus Anna Anastasiadi – Simeonidi Universitetit Aristoteleio të Thessalonikit, Kontributi i gjuhës së lashtë greke në formulimin e terminologjisë shkencore ndërkombëtare me 06.03.2020 "Kontakte ndërkulturore: arsimi grek dhe edukimi shqiptar". 19/12/2019 Referues: Doris Kyriazis, Asistent Profesor, Universiteti Aristotel i Selanikut Titulli i referimit: "Një shqiptar i shquar i shkollës "Zosimea" së shekullit XIX: Faqe nga vepra e Jani Vreto / Ioannis Brettos". Dion, Vasil Tushi, Asistent Profesor, Universiteti i Korçës Titulli i referimit: "Sotir Papahristo dhe kontributi i tij në arsim në Shqipëri". (<i>Aneksi, nr. 23</i>). <i>Pjesmarrës në këto leskione kanë qenë pedagog dhe student.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,</p>	<p>Personeli akademik duhet të respektojë dhe të jetë i gatshëm ti përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Referuar rezultateve të pyetësorit (<i>Aneksi, 37 nr.2</i>) dhe në takim me studentët, u vu re komunikimi i hapur ndaj formave të reja të mësimdhënies, raportet pedagogë - studentë shumë</p>




<p>metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>motivuese, dhe respektimi i studentëve me nevoja të veçanta dhe aftësi ndryshe. Studentët janë pjesmarrës dhe në aktivitet që lidhen me programin mësimor që ndjekin. si “Dita Botërore e Gjuhës Greke” konferenca etj. (Aneksi nr.17, nr.4.5.6).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>KU LOGOS e ka mbështetur personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Një pjesë e konsiderueshme e stafit vjen nga një përvojë e konsiderueshme akademike dhe, ndërkohë një pjesë e tyre janë dhe profesorë në universitete europiane. Leksionet e hapura janë një nga metodat e mësimdhënies që realizohen nga marrëveshjet bashkëpunimit me Universitetin Demokritus, të Selanikut, të Maqedonisë Perëndimore (Aneksi,34). Edukimi Teatral është një modul aplikuar se fundmi nga stafi mësimdhënës, si një risi e përfaqësimit të teatrit si formë e botës sonë psikike. (Aneksi 25, nr,7, 8)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është i aftë dhe me kualifikimet shkencore që kërkon ky program studimi. Për të rriur cilësinë e mësimdhënies departamenti ka në përberje të tij profesorë nga universitete të huaja. Në përgjigjet e studentëve dhe nga takimi që u zhvillua me ta, performanca e profesorëve të tyre u konsiderua cilësisht e mirë dhe motivuese.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i kësaj njësie bazë ka në planin e masave për përmirësimin NJSBC, dhe vlerësimin e vërejtjet e studentëve të dala nga anketimi. Ata vënë në pah hapat që do të ndiqen për përmirësimin e pikave të dobëta të vërejtura në raport. Në përgjigjet e pyetësorit për këtë program nuk kishte verjetje, por si pjesë e procedurës, personeli akademik merr për shqyrtimin raportin e nisur nga vlerësimet dhe pyetësorët dhe merr takime të herë pas herë për vlerësimin e kurseve, ecurinë, metodikat. (Aneksi 23), ka të përshkruar këtë proces me detaje.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Vetë programi i studimit, ka në thelb edukimin e mendimit. Senati akademik parashikon veprimtari akademike që lidhen me “mësimdhënien e të nxënit” në përfundim të çdo semestri. (Aneksi 104). Personeli akademik përpiqet të afroje studentet në diskutime interaktive, duke i lënë hapësirë dhe mendimit të pavarur. Në raportet vjetore, vihet fokusi tek gërshetimi i</p>

	mësimdhënies me kërkimin, duke i konsideruar studentët jo vetëm konsumator të kërkimit shkencor por dhe pjesë e aktive. (<i>Aneksi 35_Nr.2_Raporti Vjetor 2019-2020 i KU "LOGOS", Monitirimi i sigurisë dhe cilesisë</i>).			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga biseda me studentët dhe profesorët, dhe vizita në biblioteke vumë re që në KU LOGOS, kishte përpjekje që të krijoheshin hapsira për diskutimin e temave të pavarura dhe projekteve. Infrastruktura akdemike është në funksion të punës së pavarur të studentit (<i>Aneksi 39, nr.8</i>). Tabela 13, përshkruan planin mësimor të këtij programi, Një pjesë e kosniderueshme e orëve të progamit i përkasin kohës së studimit. GVJ vuri re se në kriterin 7 nuk identifikohet programi i i studimit "Gjuhë dhe Civilizim Grek", por "Gjuhë dhe Letersi Greke" <i>GVJ rekomandon qartësimin e emërtimit të programit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Hapësirat e KU LOGOS janë të mjaftueshme dhe cilësore për të kryer leksionet, seminarët, workshopet. Ka një numer të konsidereshëm, salla lectionesh, seminaresh, salla për praktike, biblioteke, laboratore për gjuhën greke, laboratore informatike etj. Të gjitha keto informacione të detajuara gjenden në (<i>Tabela, 16</i>).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Gjatë vizitës në KU LOGOS, vumë re që te gjitha klasat që zhvilloheshin leksionet dhe seminarët ishin të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për mësimdhënien. Institucioni ofronte 5 salla leksionesh, 5 salla për seminare, 1 laborator, 2 mjediset, salla për aktivitete, amfiteatri në katin e pare (<i>Aneksi 39, nr8</i>).
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të	Dy vite të këtij programi mësimor janë ndjekur on line po gjatë bisedës me studentët u vu re që ambinetet e cituara më sipër, si labororet e informatikës dhe plaformat on line kanë qenë në


<p>ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>funksion të procesit mësimor dhe të punës së pavarur të studentëve. Programi Google Classroom dhe Edu Page, gjatë periudhës së pandemisë Kolegji Universitar ka ngritur një ekip administrativ për të ndjekur realizimin e edukimit në distancë (<i>Aneksi 40-10</i>), gjithastu stafi është trajnuar për përdorimin efikas të këtyre platformave (<i>Aneksi 22, nr.5</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Programi “Gjuhë dhe Civilizim Grek” e ka të pashmagshëm hulumtitmin e burimeve të literatures në gjuhën greke. Vetë institucioni u ofron 2153 tituj fizik të ndarë në dy bibliotekat e kampusit. Zyra e IT operonte me tre platforma elektronike dhe ishin të listuara mbi 30 burime websit-i në gjuhën greke, me të cilat studentët mund të konsultohen për projektet, detyrat e kursit apo punimin e diplomës. (<i>Tabela 17</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Sic cituam dhe me sipër, departamenti ka një numër të konsiderueshem titujsh (343) në bibliotekën e universitetit, të dhuruar dhe nga universitetet me të cilet ka bashkëpunim. (<i>Aneksi 26, nr.6</i>) Eshtë listuar një numër i konsiderueshem titujsh i sjellë nga Departamenti Gjuhës dhe Letërsisë Greke, në Universitetin e Aristotelit. (<i>Tabela, nr.26, nr.1, 2, 3, 4,</i>)</p> <p>Vetë hapësira e bibliotekës ishte e konsiderueshme dhe ndihmonte funksionimin e këtij procesi. Gjithashtu ka nisur procesi i hartimit të një katalogu elektronik të bibliotekës që do të ndihmojë në përshpejtimin e kerkimit. (<i>Aneksi 26_Nr 6_Totali i titujve.</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Falë dhe bashkëpunimit me universitetet greke, studentët dhe personeli akademik gjatë procesit të mësimdhënies mund të konsultohen me platformat elektronike, Zephyros dhe të Bibliotekës Akadematike dhe Humane Greke. (<i>Tabela nr. 17</i>)</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Departamenti ka një laborator për gjuhën greke, por duke pasur parasysh periudhën e pandemisë, nuk është shfrytëzuar Laboratori është i pajisur me kompjuter dhe softwear, dhe u vu re se laboratori është pasuruar vazhdimisht dhe mund të shfrytëzohet gjersisht edhe për lenden e përkthimit, <i>Sic cilësohet në RVB, laboratori do të jetë funksional, kur studentët të zhvillojnë mesimin në auditor.</i></p>

<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, KU “LOGOS” në faqen e tij zyrtare http://kulogos.edu.al/al/student-portal.html në seksionin Portali i Studentit, ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit ku përfshihen lajmërimi, evente, orari mësimor, komunikime me stafin pedagogjik, vendime dhe rregullore të miratuara nga organet drejtuese të Kolegjit dhe materiale të tjera të kësaj natyre. Studentët dhe pedagoget përdorin platformat on line Google Meet, Microsoft Teams, Microsoft office 365, Edu Page (Aneksi 40, nr, 7,8,9), të cilat janë standartizuar si platforma e mësimdhënies e departamentit gjatë viti të fundit.</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Në platformat Edupage.al dhe Microsoft Office 365 si personeli akademik, ashtu edhe çdo student, mund të ngarkojnë materiale mësimore (leksione, detyra të ndryshme, prezantime, etj) që mund të aksesohen në çdo kohë nga të gjithë studentët, apo përmes llogarive të veçanta të studentëve. Gjithashtu, çdo personel akademik ka në dispozicion në këto dy platforma hapësirën e vet individuale, në të cilën mund të ngarkojë leksionet e lëndës/modulit, syllabusin, si edhe mënyrën e administrimit të lëndës përgjatë gjithë semestrit. (Aneksi 25, nr. 1,2, 3, 4, 5,6)</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Rregullorja e KU Logos i ka të përcaktuar të gjithë hapat akademik që duhet të ndiqen derisa sa student të zgjedhë temën e diplomës dhe sesi duhet të asisitojë. (Rregullorja e Fakultetit, neni 28). Gjatë takimit me studentët dhe sic është evidentuar në RVB studentët ishin përfshirë të gjithë në punim diplome. Nga biseda me studentët ata ishin përfshirë në “një projekt përkthimi” dhe mbrojtja e diplomës ishte shtyrë.</p> <p><i>GVJ konstaton që asnjë nga studentët nuk ishte përfshirë në një temë diplome për mësuesinë, duke pasur parasysh që tregu punës i studentëve, që përfundojnë këtë degë lidhet me mësuesinë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur NJSCB për të testuar dhe siguruar cilësinë e mësimdhënies. Mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë nr.9741, në vitin 2011 „Shkolla e Lartë Private “Logos” ka ngritur NJSCB pranë këtij universiteti për të vlerësuar në mënyrë periodike, efikasitetin mësimdhënien dhe punën administrative. (Aneksi 38, nr.5)</p> <p>Universiteti ka hartuar politikat lidhur me procesin e sigurisë së vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm që ka për qëllim kontrollin, vlerësimin, dhe përmirësimin. (Aneksi 38, nr.4)</p> <p>Nisur nga situata e pandemisë puna e NJSCB është lidhur edhe me cilësinë e përdorimit të platformave on line. (Aneksi 30, nr.5). NJSCB si paketë instrumenteve të tij ka dhe hartimin e pyetësorit për studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore bazë dhe NJSCB, janë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies ndërkohë ka hartuar dhe një Rregullore të Sigurimit të Cilësisë (Aneksi 38, nr.1). Si instrument bazë është përdorur pyetësori i studentëve që është pjesë e paketës së instrumenteve (Aneksi 38 nr.8). Përgjigjet e këtij pyetësori përcillen në rektorat dhe priten reflektimet.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në rregulloren e KU LOGOS, (Kapitulli 4, neni 1, pika 1), cilësohet se drejtuesi i departamentit është njëkohësisht edhe drejtues i Qendres Shkencore, e cila, mendohet të jetë përgjegjëse dhe mbështetse për metodat e reja inovative. Parimisht dhe praktikisht departamenti ka eksperimentuar metoda inovative si: mësimin e integruar, duke përshatur projektin CLIL (që ka për qëllim këtë metodë mësimdhënies) dhe Didaktikën e Gjuhës Greke.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik trajnohet dhe kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme. Stafu akademik është pjesë e kërkimit shkencor dhe gjithashtu KU LOGOS, mbështet parimisht trajnimet dhe metodat e reja të mësimdhënies. Vihet re dhe mbështetja me trajnimet e pedagogëve të rinj edhe në mobilitetet e stafit. (Aneksi 16.nr.3) Trajnim për platformat elektronike (Aneksi 22, nr.5)</p> <p><i><u>GVJ rekomandon që stafi i ri të përfshihet jo vetëm në trajnime për metodat e mësimdhënies por edhe në kërkimin shkencor. Në raportin 2019 -2020 kërkohet krijimi i një rrjeti akademik.</u></i></p>




	<i>Periudha e pandemisë e vështirësi siutatën. Rekomandohet që krijimi i rrjetit akademik të aplikohet në vitin 2021- 2022.</i>			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga biseda me stafin akademik na u bë e ditur se, institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen në konferenca apo trajnime brenda e jashtë vendit. <i>(Aneks_16_Nr.3_Zoto-Trajnim.)</i> <i>(Aneks_28_Nr.3_Marrëveshja Erasmus+, Zoto, A)</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Stafi akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit. Rregullorja e Përgjithshme e KU "Logos" përcakton me hollësi detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik (<i>neni 42</i>), të personelit të ftuar (<i>neni 44</i>), dhe të personelit ndihmës akademie (<i>neni 46</i>). Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të Institucionit. Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, metodat kryesore inovative të mësimdhënies që përdoren në KU "LOGOS" janë Edupage.al dhe Microsoft Office 365. <i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS")</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në fund të çdo viti akademik KU LOGOS, harton një raport për punën e personelit akademik dhe personelit ndihmës, (<i>Aneksi 35, nr.2,3</i>). Në raportin e Fakultetit të Shkencave dhe Komunikimit Gjuhësor, dhe, në Raportin Vjetor të Departamentit (<i>Aneksi 21</i>), jepet një informacion i plotë për punën shkencore, pjesëmarrjen në konferenca, trajnimet, noten mesatare, burimet ekonomike, si ishin shfrytëzuar nga departamentet përkatëse etj. Vihet re që nga personeli akademik është trajtuar me metoda të reja të mësimdhënies dhe ka pjesëmarrje në konferenca dhe projekte të cilat janë listuar në raporte e viteve 2018- 2019, 2019 -2020.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Metodika e vlerësimit të studentëve, mënyra e hartimit të tezës, lloji i provimit (me shkrim ose me gojë) rruga që ndjek studentin për t'u ankimuar për vlerësimet janë të përcaktuara në rregulloren e universitetit, (<i>Aneksi,2</i>) përkatësisht, (<i>neni 1.14</i>), dhe në rregulloren e brendshme të fakultetit (<i>Aneksi,3</i>), në rregulloren e departamentit, (<i>Aneksi, 4</i>) dhe në syllabuset pëkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen me metodën e vlerësimit, nga pedagogu i lëndës, rregullorja e brendshme dhe në secilin plan program (<i>Aneksin, 15</i>). Në syllabuset, e cdo lënde jepen tërësia e metodologjisë së testimit dhe të vlerësimit të njohurive dhe të dijeve të marra nga studentët, duke filluar nga pjesëmarrja në procesin mësimor, numri i mungesave të lejuara, mënyra e testimit (me gojë, me shkrim, apo i kombinuar), llogaritja e peshës që zë çdo komponent në notën përfundimtare, etj. Këto të dhëna bëhen të ditura për studentët, për çdo lëndë, përpara fillimit të zhvillimit të vitit akademik.</p> <p><i>(Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i njohurive zhvillohet me shkrim dhe gojë. I referohemi syllabuseve të lëndëve, ku përshkruhet forma e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijeve realizohet në të gjitha elementet e parashkuar në programin mësimor. Numri i pakët i studentëve krijon mundësi për një kontroll me të mirë dhe më të shpeshtë të dijeve.</p> <p>Në skemën e vlerësimit të një testi është përqindja e pikëve të përkthyer në nota. Sic vërehet më poshtë, studenti vlerësohet me notën 5 kur merr 45 pikë, ndërkohë që në ndërtimin e një testi të ngarkuar, pyetja ishte e përgjithshme.</p> <p><i>GVJ sygjeron që pyetja duhet të jetë e strukturuar në disa etapa, kërkesa, që studentin të jetë i qartë, kur realizon përgjigjen për përqindjen e pyetjes që realizon, pra kur vlerësohet me 46, apo 47 apo 53 pikë. Testi mund të jetë dhe më me pak pikë por secila prej tyre të jetë e lidhur me një kërkesë të pyetjes.</i></p> <p>Pikët 1 - 44 45 - 54 55 - 64 65 74 75 – 84 85 - 94 Mbi 95</p> <p>Nota 4 5 6 7 8 9 10</p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Kontrolli i dijeve realizohet në të gjitha elementet e parashikuar në programin mësimor. Dijet dhe aftësitë profesionale të studentëve testohen gjatë gjithë vitit akademik. Në syllabuset, modulet dhe gjatë komunikimit me studentë e pedagogë u informuam me format e vlerësimit që nga diskutimet, punët e pavarura, projektet, minitestet dhe përqindjen që zë çdo vlerësim në provimin perfundimtar. (<i>referuar syllabusve 1, 8, 11</i>).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në KU LOGOS, nuk ka ndonjë sistem elektronik të vlerësimit të dijeve, gjithsesi numri i vogël i studentëve jep mundësi për transparencë të plotë. Profesorët sic referohet në RVB operojnë në vlerësim për detyra sintetike.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i aftësive profesionale, realizohet nga komisionet e provimeve. Ky proces është standartizuar dhe në rregulloren e përgjithshme të KU LOGOS dhe në rregulloren e departamentit, e cila është zbatuar me përpikmëri edhe gjatë periudhës së pandemisë. <i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS")</i> <i>(Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek)</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Referuar, RVB, syllabusve dhe rregulloreve përkatëse, u konstatua se testimi i njohurive me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime. Gjithsesi numri i vogël i studentëve dhe shumëllojshmëria e formave të kontrollit e bën të pamundur anonimatin. Si ilustrim i jemi referuar provës së testit të njohurive të Latinishtes. (<i>Aneks_27_Nr.1_Provim Semestral, Latinisht</i>).

<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregullorja e përgjithshme KU LOGOS dhe Rregulloja e Departamentit ka të parashikuar të drejtën për ankimit dhe rezultatit të provimit. Nga takimi me studentët dhe pedagogët u informuam se, çdo studenti i jepet e drejta për komente dhe ankime të rezultatit. Studentët kanë të drejtë të marrin këshilla dhe komente mbi testet e kryera. U konfirmua se e njëjta procedurë është ndjekur dhe me formën e studimit online.</p> <p><i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS", neni 99).</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Kodi dhe Rregullorja e Etikës së Kërkimit Shkencor, në KU LOGOS, ndalon plagjiaturën në punimet e studentëve. Departamenti është i pajisur edhe me sistemin antiplagjiaturë. Në takimin me studentët u konfirmuan të gjitha rregullat që lexohen në Kodin e Etikës dhe zbatohen me përpikmëri.</p> <p><i>(Aneks_36_Nr.1_Kodi i Etikës, neni 1,2).</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen sipas aftësive përkatëse. Në fund të çdo syllabusi janë përcaktuar të gjitha format e kontrollit gjatë vitit me përqindjet përkatëse deri në vlerësimin përfundimtar. Studenti njihet që në fillimi të vitit akademik, me formën e kontrollit dhe të drejtën e ankimit, menjëherë do të informohet për rezultatit të provimit me gojë ose shkrim është përcjellë në rregulloren KU LOGOS.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Përgjithshme sipas <i>(neneve 99-102)</i>, jepen rregulla të përcaktuara në mënyrë të qartë për zhvillimin e provimeve, oraret, mënyrën e kontrollit, të shpalljeve të rezultateve, të ankimeve, të riprovimeve, etj. Në këtë rregullore, parashikohen edhe ankimi për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit <i>(neni 100)</i>, si edhe ankimi për rezultatit të provimit <i>(neni 101)</i>.</p> <p><i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS" neni 99-102)</i></p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në RVB përshkruhet procedura e ankimit të parashikuar në rregullore, por mbetet, e paverifikueshme zbatueshmëria e saj, sepse gjatë gjithë kohëzgjatjes zyrtare të këtij programi, nuk ka pasur ankime nga studentët.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Gjuhë dhe Civilizim Grek” i ofruar nga FSHKGJ, është licensuar për herë të parë me Urdhër Nr. 433, datë 20.07 20218, të MASR.</p> <p>Ky program është ofruar fillimisht nga Departamenti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, i cili, me rekomandim të një komisioni të posaçëm, në vitin 2020, ka ndryshuar emërtimin, në Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek. (<i>Aneks_18_Nr.1_Relacion</i>). Ky program është përmirësuar duke pasur parasysh nevojat dhe njohuritë që iu duhen studentëve për të nesërmen. I ndarë në dy grup lëndësh: Gjuhësi dhe Civilizim është pasur parasysh që në të parën të krijohen njohuri të mira bazuar në traditën filologjike dhe në njohuri bashkëkohore. Po kështu e njëjta përpjekje në letërsi dhe civilizim. Për këtë një ngarkesë të krenaqshme orësh zënë lëndët praktike, por dhe ato të formimit teorik (drejtshkrim, gramatikë, letrësisë greke etj.) Sylabuse që mbulojnë lëndët e gjuhës dhe civilizimit iu japin mundësi studentëve me prirje letrare t’i zhvillojnë dhe ti pasurojnë më tej ato. Këto njohuri i ndihmojnë dhe në fushën e studimeve filologjike, në mësimdhënie dhe për mundësinë e punësimit në fushën e turizmit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Si program studimi, i cili mbulon një fushë të shkencave humane, pothuajse të gjitha lëndët dhe modulet që zhvillohen në këtë program kanë si bazë, komunikimin. Për të zhvilluar aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe gjuhës së huaj, si lëndë plotësuese janë përfshirë në program, gjuha angleze dhe gjuha latine.</p> <p><i>Në program nuk ka të listuar modul si Teknologjia e Informacionit, por në faqen web të universitetit është përfshirë sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p>


<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Objektivat e çdo lënde janë vendosur në krye të çdo syllabusi. Njohuritë e përfituara nga çdo modul dhe aftësitë profesionale që ka marrë studenti nga lënda përkatëse, përkthehet edhe në notën me të cilën i janë vlerësuar dijet në provimin përfundimtar, përcillet një proces verbal i takimit të pedagoqeve, ku përcillet në mënyrë të individualizuar arritjet e çdo studenti. Vlen të theksohet se numri i vogël i studentëve jep mundësi për analize të detajuar.</p> <p><i>(Aneks_23_Nr.2_Proces-verbal takimi (studenti))</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Përpara provimit përfundimtar, stafi akademik zhvillon edhe konsultime dhe orienton studentin drejt çështjeve thelbësore të disiplinës. Për këtë studentët njoftohen edhe për vendndodhjen (zyrën) dhe orarin e pedagogut përgjegjës. Sic u informuam dhe gjatë takimit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Ky department është i ri, por ka përpjekje për realizimin e orëve të hapura mbi zhvillimet e reja të shkencës. Vlen të përmendet, kumtesa e mbajtur nga Profesoresha e Asociuar, Tiktopoulou, në kuadër të Festimit të Ditës Botërore të Gjuhës Greke. Gjithashtu, seminari Trajnimit të Mësuesve të Gjuhës Greke, ka vlerë për të krjuar hapësira për përmirësimin e mesimdhënis.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë bachelor, në “Gjuhë dhe Civilizim Grek”, parashikon praktika profesionale nëpër shkollat e ngritura nga fondacioni “ Frymë Dashurie”, dhe punë laboratorike të përkthyer, në punë kerkimore. Tema e diplomës kishte parashikuar: hartimin e një fjalori të anasjelltë, në gjuhën shqipe, sipas të njëjtës metodë në gjuhën greke. Gjatë vizitës u informuam që tema e diplomës është shtyrë për tu mbrojtur në shtator. <i>(Aneks_19_Nr.3_Vendim për Temat e Diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik i DGJCG mbështet nismat dhe punët e përfaqësuese të studentëve duke qenë mbështetës dhe këshillues të tyre. Gjatë orëve të mësimi, veçanërisht të seminareve nxiten studentët për diskutime në grup, punë të pavarura e detyra kursi. Ky informacion u konfirmua dhe gjatë takimit me studentët.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kerkimore e</p>	<p>Stafi akademik i DGJCG ka krijuar një klimë të përshtatshme ndihme dhe inkurajimi për të mbështetur dhe asistuar shkencërisht punën e studentëve në këtë fushë studimi. Punët shkencore të studentëve i janë paraqitur në Revistën</p>

shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Studentore nr.2. të KU LOGOS. Studentët janë bërë pjesë dhe e tryezave të diskutimeve shkencore dhe promovimi veprash letrare. Ata marrin pjesë edhe në diskutimet e temave të kursit që diskutohen në orët e mësimit. <i>(Aneks_17_N.1_Aktivitet I_19_12_19)</i>			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	KU LOGOS i ka mbështetur financiarisht botimet e studentëve, sic përmendëm dhe më siper punimet e tyre ishin botuar, në Revistën Studentore të Universitetit.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimit me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Ky Departament i ka ndërthurur format e mësimit me institucione të tjera bashkëpunuese duke pasur parasysh që një pjesë e stafit akademik vjen nga universitetet publike greke dhe janë pjesë e aktive e kërkimeve shkencore. Sipas informacioneve që morëm dhe dokumentacionit të paraqitur, për shkak të pandemisë, nuk është finalizuar mobiliteti i studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e KU LOGOS (<i>Kapitullit IXV</i>), është përcaktuar procedura e provimit të diplomës. Studentët e kanë të qartë që duhet të japin provim ose temë diplome, nëse kanë plotësuar kriterin e mesatares. Kjo u është bërë e ditur edhe nga Sekretarisa Mësimore dhe Koordinatori për Marrëdhëniet e Punës me Studentët. Për këtë është hartuar dhe programi i provimit përfundimtar, i cili iu vihet në dispozicion studentëve. Në këtë departament, siç na u pohua nga pedagogët, të gjithë studentët i nënshtrohen punimit të diplomës, sepse mesatarja gjatë tri viteve të ciklit të parë shkon sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara mbi 9. Nga studentët na u pohua që janë në procesin e punimit të temës së




	diplomës. (<i>Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS"</i>)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion, programin e provimit të diplomës, literaturën e nevojshme, të cilat të fotokopjuar lihen në sekretari dhe janë të gatshëm për pyetje dhe konsultime për studentët, si dhe për t'i ndihmuar me literaturën e nevojshme. Ky informacion u konfirmua edhe gjatë takimit me studentet.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Procedura e diplomimit ngarkon përgjegjësin e departamentit të GjCG, të krijojë një komisionin prej pesë anëtarësh për të hartuar tezën e provimit, e cila ndërtohet duke pasur parasysh formimin e studentëve, gjatë 3 viteve të studimit, të shprehura këto, në Vendimin nr.10, datë 21.03.2021.(<i>Ankesi 21</i>). <i>GJVJ rekomandon departamentin për nevojën e parashikimit dhe mundësisë që me shtimin e numrit të studentëve të hartojë një bankë pyetjesh edhe për studentët që nuk arrijnë kriterin e mesatares së vendosur nga departamenti.</i> <i>(Aneks_21_Raporti Vjetor i Departamentit GJCG (2019-2020))</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik është gjithmonë në gatishmëri për të ndihmuar studentët. Në RVB është parashikuar me detaje edhe përgatitja e temës së diplomës nga studentet. Referuar (<i>neni 113</i>), të rregullores së kolegjit parashikohet procedura e vlerësimit me provim. <i>GJVJ këshillon që të përgatitet edhe një bankë pyetjesh për provimin e diplomës</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga bisedat me stafin akademik, rezulton se pedagogët, sipas moduleve që ofrojnë, asistojnë studentët gjatë orëve praktike në mjediset e Kolegjit Universitar "LOGOS" apo në orët praktike që ata realizojnë në institucionet pritëse me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Për vitet 2019-2020 ky proces ka patur kufizimet e veta për shkak të pandemisë.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose	Sipas udhëzuesve të miratuar, udhëheqësi i diplomës e ndihmon studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës. Udhëheqësi harton një plan konsultimesh dhe rekomandimesh duke hartuar dhe një grafik të detajuar deri në perfundim të punimit. Nga bisda me studentët u informuam se mbrojtja e temës së diplomës ishte

jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	shtyrë për në shtator por ata konfirmuan që procesi i kërkimit ishte asistuar me kujdes nga pedagogët.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar (<i>Neni 112</i>) të rregullores së KU LOGOS, parashtrohet procedura e mbrojtjes së diplomës vlerësimit. Neni 113, përshkruan dhe procedurën e vlerësimit nëse studenti zgjedh provimin e formimit.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Kur studenti ka përmbushur të gjitha kërkesat akademike dhe financiare ndaj KU LOGOS, sekretaria mësimore, plotëson dhe pajis çdo student me diplomën dhe suplementin, ku përshkruhet natyra e studimeve, niveli përmbajtja dhe rezultatet e studentit. Ky proces është parashikuar edhe në rregulloren e KU Logos, (<i>neni 114</i>). (<i>Aneks_31_Modeli i diplomes.</i>)			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Procesi i pajisjes së studentit me kopje të programit të zhvilluar është i parashikuar dhe në rregulloren e Kolegjit. Pasi studenti ka përfunduar detyrimet financiare, kundrejt institucionit në bazë të një tarife që përcaktohet me vendim Senati, studenti mund të tërheq kopje të programit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore mban dhe ruan në mënyrë të përhershme: <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin e studentëve; - Regjistrin e arritjeve akademike; - Regjistrin e ruajtjes së suplementit dhe diplomës; - Regjistrat (2 dhe 3) plotësohen me shkrim dore dhe në formë elektronike; Regjistri themeltar plotësohet vetëm me shkrim dore dhe nuk korrigjohet për asnjë arsye			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Standardi IV.1**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Referuar (<i>Aneksit 2, Kreu V, neni 43</i>), institucioni arrin të mbledh të ruaj dhe të përditësojë të dhënat e personelit të angazhuar në KU Logos. Gjithashtu edhe nga vizita e organizuar në këtë Kolegj dhe nga kontakti me Shefen e Burimeve Njerëzore, u vu re mbajtja e dosjeve të veçanta për çdo pedagog të përfshirë në program dhe në dosje gjendeshin materiale përfaqësuese të secilit pedagog, si CV, titujt dhe arritjet shkencore, pjesëmarrja në aktivitete shkencore e botime në revista të ndryshme shkencore, për angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër si dhe të personelit shkencor e administrativ.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Evidentohet se institucioni ka procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin e stafit. Këto procedura janë në përputhje me bazën ligjore referuar (<i>Aneks_33_Nr.2_Marreveshje per percaktimin e numrit te personelit akademik me kohe te plote ne njesite baze_MASR</i>) Të gjitha këto të dhëna u shprehen dhe u evidentuan edhe prej Shefes së Burimeve Njerëzore. Po ashtu mbi rekrutimin referon edhe rregullorja e KU Logos. (<i>Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS", Kreu II në nenet respektive 43, 44, 45</i>)
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Në kuadrin e strategjisë së tij, institucioni harton kritere specifike për rekrutim personeli të cilat burojnë nga niveli i njësisë bazë dhe i paraqiten për zbatim hierarkisë vepruese: dekanit e rektorit dhe komisionit ad-hoc i cili caktohet për rekrutimin e stafit. Raportet midis stafit pedagogjik të punësuar rregullohen në bazë të kontratës të punës dhe të Kodit të Punës, në respektim të plotë me Legjislacionin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. (<i>Aneks_10_Politika dhe procedura të Burimeve Njerëzore.</i>)
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që	GVJ evidentoi se institucioni kërkon paraqitjen e dosjeve respektive të pedagogeve dhe grupi i punës, komisioni ad-hoc që merret me vlerësimin e dosjeve garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit në varësi të secilit



garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	program studimi që do të aplikohet pasi kalon nga miratimi sipas hierarkisë dekan-rektor. Ky fat gjendet i qartësuar në dokumentin <i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS", neni 43-48)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2



Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ gjatë vizitës në KU. "Logos" konstatoi se mjediset ishin tepër të përshatshme për kryerjen e detyrave të personelit në kushtet e barazisë dhe me gjithë pajisjet e nevojshme për kryerjen e çdo aktiviteti të nevojshëm në kuadrin e kurrikulave ekzistuese. <i>(Tabela 16)</i> . Angazhimi institucional ishte mëse i plotë mbi përmbushjen e këtij kriteri duke stimuluar vazhdimisht personelin akademik të marrë pjesë në aktivitete shkencore e duke mundësuar botimin e artikujve dhe akteve të konferencave edhe përmes Revistës Shkencore të vetë institucionit, <i>(Aneks_22_Nr.9_Informacione mbi konferencat)</i> . Prania e aksesit të lehtë e të menjëhershëm në rrjetin e internetit ishte e garantuar.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	GVJ evidentoi se, institucioni ofron dhe sjell në kontakt personelin e tij me të dhëna dhe informacione për zhvillim të mëtejshëm profesional duke organizuar konferenca dhe workshop me Univeristete të Greqisë dhe të Evropës, ku zakonisht propozohen të kryhen në fillim të vitit akademik. Kualifikimi i vazhdueshëm ishte edhe një ndër pikat prioritare të vetë dekanit sipas dokumentit <i>(Aneks_9_Mendimi i Dekanit, Programi i Gjuhes Greke, 23.04.2021)</i> . <i>(Aneks_33_Nr.3_Informacion lidhur me zhvillimin, integrimin dhe pjesëmarrjen e personelit të Kolegjit Universitar "LOGOS")</i>

	<i>(Aneks_34_Seminar Zhvillimi Personel Akademik)</i>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Evidentohen trajnime të ndryshme në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies dhe të kualifikimit të stafit akademik, përmes bashkëpunimeve me Univeristete të Greqisë dhe gjen hapësirën e duhur përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit përsa i përket komunikimit në distance duke përdorur platformën TEAMS dhe EDUPAGE, si për komunikimin me studentët ashtu edhe për organizimin e trajnimeve me karakter profesional për personelin akademik.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Vërehet angazhim i vazhdueshëm për përbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë dhe kjo evidentohet nga anketimet e kryera ku personeli akademik në fund të çdo viti akademik i nënshtrohet vlerësimit periodik. <i>(Aneks_10_Politika dhe procedura të Burimeve Njerëzore, pika 3.3)</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ gjatë vizitës në KU Logos. Konstatoi se institucioni ka në zotërimin e tij mjedise të mjaftueshme e tepër të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse e kjo duke marrë parasysh numrin e studentëve në lidhje me programin e studimit Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek. Studentët kishin hapësira të bollshme studimi, laboratorë përkthimi, parametra optimalë ndriçimi, akustike dhe ekoizolimi. Ndërtesa plotësonte të gjitha kushtet higjieno-sanitare për zhvillim normal të aktiviteteve didaktike. <i>(Aneks_39_Nr.8_Infrastructura akademike ne funksion)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së	Realizimi i procesit mësimor teorik e praktik, mund të zhvillohet më së miri në mjediset e Kolegjit Univeristar Logos, pasi u konstatua larmi e madhe pajisjesh elektronike dhe pajisje të teknologjisë së informacionit që mundësojnë e



<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>garantojnë aplikimin e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Aksesit në internet të lire dhe të shpejtë për të gjithë studentët dhe pedagogët mundësonte interaktivitet mes tyre në format bashkëkohore ndërveprimi. Të gjithë auditorët janë të pajisura me mjetet audio vizive të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor efektiv, ku përfshihen kompjuter personal, video projektor, sistem fonie dhe tabela interaktive.</p> <p>Gjatë pandemisë mësimdhënia online u zhvillua nëpërmjet platformës (EduPage), si dhe nga një platformë ndërmjetësuese e komunikimit midis aktorëve të ndryshme të proceseve të këtij programi studimi (MS-TEAMS).</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në bazë të evidentimit, nga vizita në Institucion, disponoheshin të gjitha mjetet e posaçme për realizimin teorik e praktik të objektivave formues të programit. Vend të veçantë kishin laboratorët të pajisur me kompjuter me programe të përshtatshme në shërbim të arritjes së objektivave të kurrikulave së gjuhës së huaj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni ofron më tepër se një laborator të teknologjisë së informacionit me akses të lehtë, me internet të shpejtë dhe të lire për të gjithë për të shfletuar dhe për të shkarkuar nga bibliotekat elektronike në çdo moment, literaturën e nevojshme dhe literaturën e kërkuar për studime të thelluara dhe jo vetëm.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni ku zhvillon mësimin Departamenti i Gjuhës dhe i Civilizimit Grek garanton më së miri të gjitha kapacitetet e nevojshme të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe të veprimtarive të tjera praktike. (Tabela nr. 16)</p> <p>Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës, me Fondacionin “Frymë Dashurie”, etj. për realizimin e praktikave mësimore të studentëve. (Aneks_28_Nr.2_Marrëveshja me Fondacionin Frymë Dashurie.)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e Institucionit u konstatua se studentët që zgjedhin drejtimin Gjuhë dhe Civilizim Grek përveç bibliotekës që gjendet brenda godinës së Kolegjit Logos në Tiranë, kanë akses edhe në bibliotekën në kampusin "Ngjallja" në Shën Vlash të Durrësit. Të gjithë studentët përveç literaturës së gjerë që gjendet fizikisht në mjediset e dy Bibliotekave në dispozicion të tyre, kanë akses përmes elektronikës të vizitojnë faqe interneti të bibliotekave elektronike, nga të cilat mund të shkarkojnë pjesë të literaturës që u nevojitet për përgatitjen e temave të diplomave dhe për detyrat e kursit që u ngarkohen nga pedagogu përkatës.</p> <p><i>(Aneks_26_Nr.2_Proces-verbal mbi hyrjen e e librave në Bibliotekë nga fondacioneoraganizata)</i></p> <p><i>(Aneks_26_Nr.3_Proces-verbal mbi hyrjen e e librave në Bibliotekë dhurues privatë)</i></p> <p><i>(Aneks_26_Nr.4_Rregullore e miratuar e Bibliotekes_13 02 2019)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se edhe vetë pedagogët kanë mundësuar pasurimin me tituj librash të bibliotekës, për të plotësuar fushat e studimeve që ofrohen në programet e Departamentit të Gjuhë dhe të Civilizimit Grek. Konstatohet një game e gjerë dhe deri diku e mjaftueshme titujsh që studentët mund të përdorin në kuadrin e studimeve të tyre. Vlen të theksohet përpjekja e vazhdueshme nga drejtuesit e bibliotekës për pasurim të vazhdueshëm të fondit libror me tituj që i shërbejnë studimeve krahasuese cilësore dhe sasiore midis shqipes edhe greqishtes.</p> <p><i>GVJ rekomandon që ka ende nevojë edhe për më tepër botime që lidhen drejtpërdrejt me planin mësimor, referuar edhe dok (Aneks_26_Nr.8_Strategjia e bibliotekes 2019-2023; Aneks_26_Nr.5_Pasurimi i Bibliotekës 2018-2021)</i></p>





<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i ka krijuar kushtet e shfrytëzimit në kushtet e barazisë dhe fondit libror on-line sipas fushës së kërkimit është pa pagesë për studentët e këtij institucioni. Përmes bibliotekës ndërkombëtare on-line Questia On-Line Library studentët dhe personeli pedagogjik mund të shfrytëzojnë literaturë të bollshme në përgatitjen e tezave të ndryshme që dëshirojnë të studiojnë. Gjatë vizitës në Institucion ekzistonte angazhimi edhe për një zgjerim të fondit të shfrytëzueshëm përmes bashkpunimit me bibliotekën on-line të Universitetit Aristotelis të Thessaloniki.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës që GVJ realizoi në mjediset e Kolegjit Universitar Logos, konstatoi se në ambjentet e bibliotekës ekzistonin të gjitha pajisjet teknike dhe programet bashkëkohore kompjuterike për shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme në studim.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Gjatë diskutimit me drejtuesen e bibliotekës, u konstatua një angazhim maksimal për pasurimin e fondit me tituj të rinj që i përshtaten programeve studimore. Pasurimi i fondit mundësohej përmes blerjeve, ndërkëmbimeve dhe dhurimeve. (Aneks_22_Nr.10_Porosit e librave) (Aneks_26_Nr.2_Proces-verbal mbi hyrjen e e librave në Bibliotekë nga fondacioneoraganizata)</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se biblioteka qendron e hapur nga ora 08:00 deri në orën 20:00, dhe është në shërbim të studentëve dhe të pedagogëve të institucionit. E shtuna dhe e diela ishin ditë pushimi, sikundërse edhe ditët e festive zyrtare. Orari i funksionimit ishte i shpallur në hyrjen kryesore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi i informacionit që lidhet me studentët realizohet nga sekretaria mësimore e programit të studimit, kryesekretaria e fakultetit si dhe administrator. Kjo u vërtetua edhe në takimin që realizuam gjatë vizitës në institucion me punonjëset e sekretarisë mësimore të cilat kishin një bazë të plotë të dhënash për çdo student, kryesekretaren dhe personelin e Administratës. Aty u prezantua me regjistrin themeltar dhe dokumente të tjera që lidheshin me aktivitetin e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në fazën e diplomimit. Studentët dispononin në sekretarinë mësimore një kopje fizike të dosjes së tyre, por edhe një kopje elektronike e cila përditësohej sipas ecurisë së studimeve dhe arritjeve të studentëve.</p> <p><i>(Aneks_40_Nr.2_Politika e privatësisë web LOGOS)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referur RVB dhe vizitës në sekretarinë mësimore u prezantua sistemi 'Edupage' në kompjuter, i cili siguron informacion dhe komunikim të studentët për të dhënat personale, vlerësimet e tyre, prezencën në mësim, etj.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore, u informuam dhe pamë se aty gjendeshin të arkivuara dokumenta e të dhënat mbi aktivitetet e stafit akademik, përfshirë kualifikimet shkencore, kontrata e punës, CV-të, etj. Aty u njohëm gjithashtu me dosjet e stafit të angazhuar në programin e studimit, për mënyrën se si përdorin sistemin Edupage për ruajtjen dhe pasurimin e informacionit për secilin anëtar të stafit. <i>(Aneks_40_Nr.3_Edupage Personeli shembull)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi operativ që përdorej ishte sistemi EduPage i cili i mundësonte akses të dedikuar mbi të dhënat e pedagogëve dhe të studentëve duke hyrë me një llogari vetjake e duke shënuar emrin e përdoruesit dhe kodin e hyrjes në system. Nga takimi në sekretarinë mësimore u konstatua se ruhej çdo gjë dhe në versionin fizik/të printuar. <i>(Aneks_40_Nr.3_Edupage Personeli shembull)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ekzistojnë dhe janë funksionale nën kujdesin e grupit të IT-së platformat dhe modulet që mundësojnë komunikimin interaktiv. Gjerësisht përdoret platforma TEAMS ku vetë institucioni ka çelur emrat e përdoruesve me adresat e tyre dhe ju ka dhënë kodet e aksesit në platformë për bashkëpunime dhe lëvizje interaktive për realizimin e programit didaktik.</p> <p><i>(Aneks_40_Nr.4_Microsoft 365 Teams)</i></p>






<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Rezulton se sistemi ofron dhe garanton monitorim në kohë reale si për aktivitetin akademik ashtu edhe për atë administrativ, e kjo realizohet përmes programeve EduPage dhe Microsoft 365 të cilat ju përcjellin në kohë reale vlera drejtuesve dhe titullarëve të institucionit për të bërë vlerësimet e tyre e për të marrë masat e nevojshme aty ku e shohin të arsyeshme për përmbushjen më së miri të programeve studimore që mund të raportohen me mangësi.</p> <p><i>(Aneks_40_Nr.6_Monitorimi i aktivitetit në Microsoft 365).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Ofrohet shpërndarje e gjerë në lidhje me e informacionet që duhet postuar përmes faqes zyrtare eksistuese të Kolegjit Universitar ‘Logos’ ku mund të shquhen qartazi të dhëna mbi programet e studimit, personelin akademik, aktivitete e veprimtari akademike, por aty gjendet edhe baza ligjore e funksionimit të Kolegjit, të dhëna mbi strukturën organizative, të dhëna mbi departamentet ekzistuese dhe personelin e tyre akademik e të gjitha këto ofrohen në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Kjo u vërtetua pas kontrollit të faqes së internetit: www.kulogos.edu.al</p> <p><i>(Aneks_40_Nr.5_Website)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni harton raport financiar më të përgjithshëm në rastin e programit Gjuhë dhe Civilizim Grek, pasi pretendon se ofrohet një mbështetje e siguar për këtë departament nga vetë Fondacioni Logos. Duke qenë se ky program me një numër të moderuar studentësh, përllogaritjet vërehen në një plan më të gjerë në nivel institucioni dhe jo në nivel të njësisë bazë që është Departamenti i Gjuhës dhe i Civilizimit Grek. Si rrjedhojë (Tabela 18) shpreh të grupuara të ardhurat dhe financimet të vështruara në prizmin e</p>






	trevjeçarit akademik të parë të funksionimit 2018/2019-2019/2020- 2020/2021.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Rezulton se Institucioni ka një Plan të financimit, të hartuar në nivel institucional (<i>Aneks_41_Nr.4_Projekt buxheti 2020-2024</i>). Plani i financimit të programit të studimit përfshihet brenda kuadrit të përgjithshëm të financimit të veprimtarive të institucionit. Nuk kemi evidentuar një plan specifik për financimin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek në veçanti pasi trajtohet për momentin i integruar në një kuadër më të gjerë të Fakultetit të Shkencave Humane nga Fondacioni LOGOS.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Në bazë të vizitës në Institucion dhe sipas deklarimeve, përcaktohet një ekspert kontabël i autorizuar për të procesuar auditin e jashtëm konform të gjitha rregullave dhe standarteve. Auditimi kryhet çdo vit dhe regjistrohen të dhënat e situatës financiare mbi bilancin e realizuar të çdo viti akademik. Raporti i auditit përfshin të dhëna mbi cilësinë e mësimdhënies, veprimtarinë e procesit mësimor dhe cilësinë e shërbimit që i ofrohet studentit <i>Aneks_41_Nr.2_Raport i Auditimit 2019</i> <i>Aneks_41_Nr.3_Sugjerimet e njësive azë mbi përpilimin e Projekt-Buxhetit të KU LOGOS</i> <i>Aneks_41_Nr.5_Realizimi Buxhetit 2018-2019-2020</i>
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar	Konstatohet se Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluar dhe sivjet është hera e parë që realizohet mbyllja e ciklit të plotë të studimit të programit Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek. Sipas deklarimeve me mbylljen e ciklit të parë pritet eventualisht të realizohen edhe raportet financiare për këtë cikël studimi sipas (<i>Aneks_41_Nr.8_Raportimi Financiar 2020</i>) dhe (<i>tabela 18</i>) në lidhje me të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit. Për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale,

ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	raportet financiare i paraqiten për shqyrtim Bordit Drejtues, Fondacionit dhe Bordit të Administratorit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Qëndrueshmëria financiare garantohej sipas deklarimeve të vetë Administratorit nga vetë themeluesi i Fondacionit Logos. Vetë volumi i shtrirjes së aktivitetit mundëson një qëndrueshmëri pasi është tepër kompakt në këto vite të para të funksionimit të tij dhe gëzon mbështetje të plotë financiare. Pasqyrimi i mbështetjes financiare vërehet në <i>(Aneks_41_Nr.9_Miratim i Badmin-buxheti 20 dhe afatmesem)</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni politikat dhe procedurat e hartuara i mobilizon në bazë të rregulloreve të QSHA, RASH dhe në bazë të akteve rregullatore të Ministrisë së Arsimit. Hyrja e studentëve në programet e studimeve realizohet pas publikimit të kritereve në faqen e internetit: www.kulogos.edu.al. Gjithashtu institucioni bazohet tek propozimet e bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik për kuotat dhe kriteret.</p> <p><i>Aneks_1_ Statuti i KU "LOGOS</i></p> <p><i>Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek</i></p> <p><i>Aneks_5_Plani Strategjik i zhvillimit të KU "LOGOS", 2018-2024</i></p> <p><i>Aneks_42_Nr.1_Rregullore e Keshillit Studentor</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia në të drejta garantohet nga transparenca informuese që shoqëron programet dhe politikat që ky institucion ndjek. Nuk lejohen diskriminimet dhe anshmëria mbi baza: etnike, gjuhësore, racore, politike, mendime, filzofike, dhe fetare, nga të gjithë anëtarët e personelit të KU Logos. Lehtësime infrastrukturore në kuadrin e barazisë dhe të drejtave të njëjta ofrohen edhe për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p><i>(Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS, Neni 10).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, konstatuam se informacioni lidhur me programin e studimit, që nga procedurat e pranimit e në vazhdim, ishte i qartë. Informacioni i nevojshëm për transferime, njohje programesh, procedurat, personat e autorizuar për sqarime jepet përmes broshurave, fletëpalosjeve, faqes zyrtare të internetit të institucionit dhe shpërndahen në shkollat e mesme, në panairët e ditëve të informimit e të karrierës.</p> <p><i>(Aneks_42_Nr.12_Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta pranimi duke ndjekur rregullat dhe kriteret</p>



<p>veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>që caktohen nga Ministria e Arsimit. Publikimet bëhen përmes faqes zyrtare të internetit që Institucioni ka në dispozicion: www.kulogos.edu.al. Përzgjedhja e kandidatëve për ciklin e parë konform politikave transparente ku të gjithë kandidatët kanë akses monitorimi e që nuk devijojnë nga ligjet në fuqi dhe nga kuadri i autonomisë akademike.</p> <p><i>Aneks_1_ Statuti i KU "LOGOS</i></p> <p><i>Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek</i></p> <p><i>Aneks_5_Plani Strategjik i zhvillimit të KU "LOGOS", 2018-2024</i></p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas RVB-së, pranimi i studentëve në programin e studimit realizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe janë të mirëpritur student të huaj e student nga trojet. Refruar dokumentit (<i>Aneks_42_Nr.13_Statistika mbi Studentë të huaj në LOGOS_2017-2020</i>), vërehen regjistrimet e kryera deri më tani. Ekziston për Programin Gjuhë dhe Civilizim grek kriteri i njohjes së gjuhës të huaj që duhet të jetë në nivelin B1 dhe kush nga kandidatët nuk e arrin duhet të ndjekë kurse intensive përgatitjeje sipas dokumentit (<i>Aneks_19_Nr.4_Vendim për Kriteret e pranimit në Programin e Studimit GJCG</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik, periudha mars-maj nis me përcjellen e udhëzimeve në faqen zyrtare të internetit të institucionit: www.kulogos.edu.al/al/admissions.html, me shpërndarjen e broshurave dhe fletëpalosjeve, me transmetimin në radiostacione si p.sh. Radio "Ngjallja" e një pakete të plotë informacioni mbi fushat dhe programet e studimeve që ofron Kolegji Universitar LOGOS. Të dhëna me karakter informative gjenden edhe në media sociale, reklamat përmes YouTube, reklamat në televizione kombëtare, pjesëmarrjet në panaire, open day etj. Këto të dhëna gjenden të pasqyruara në dokumentin (<i>Aneks_42_Nr.14_Politika e Marketingu te programit te studimit_Format e tij_Transparenca me publikun</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara në institucion me studentët, personelin akademik dhe përgjegjësen e departamentit, u informuam se në javën e parë të vitit akademik, institucioni organizon me studentët, stafin akademik dhe ndihmës akademik javën orientuese, në të cilën studentët informohen me aspekte të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu planin mësimor, programet lëndore, mënyrën e vlerësimit, kriteret e progresit, rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit etj. Pasqyrimi i këtyre të dhënave gjendet në dokumentat e mëposhtëm.</p> <p><i>Aneks_21_Raporti Vjetor i Departamentit GJCG (2019-2020</i> <i>Aneks_10_Politika dhe procedura të Burimeve Njerëzore</i> <i>Aneks_3_Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor</i> <i>Aneks_4_Rregullore e Gjuhe dhe Civilizim Grek</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sipas RVB-së dhe nga takimi i realizuar me personelin akademik, konstatoam se studentët e programit informohen lidhur procedurat përkatëse të kualifikimeve dhe të transferimeve sipas rregullores, statutit dhe akteve ligjore në fuqi. Po ashtu informimi i studentëve lidhur me këtë pike realizohet edhe përmes faqes zyrtare të internetit.</p> <p><i>Aneks_17_N.1_Aktivitet I_19_12_19</i> <i>Aneks_19_Nr.5.1_Transferim Fakulteti mbi transferimet</i> <i>Aneks_34_Seminar Zhvillimi Personel Akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ ka realizuar me studentët në institucion, konstatoam se ata informohen lidhur me kriteret e vlerësimit të dijeve të tyre në fillim të vitit akademik nga vetë anëtarët e departamentit.</p> <p><i>Aneks_23_Nr.2_Proces-verbal takimi (studenti)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët u informuam se këta të fundit njiheshin nga pedagogët përkatës të përhershëm të Departamentit në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit. Gjithashtu procedurat dhe kriteret e punimit të diplomimit janë të përcaktuara edhe në rregulloren e programit të studimit.</p>

	<p><i>Aneks_3_Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor Kreu VII, Neni 28.</i></p> <p><i>Aneks_19_Nr.3_Vendim për Temat e Diplomës</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me personelin akademik dhe studentët, u informuam se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik, institucioni organizon fushata orientuese dhe këshillimore, në të cilën studentët qartësohen mbi objektivat dhe elementet e tjera të programit të studimit si dhe arsyet se përse mund të jetë kandidatë të një programi studimi në këtë Institucion.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Gjatë nisjes së vitit të ri akademik, institucioni organizon me studentët, stafin akademik dhe ndihmës akademik fushatën orientuese, në të cilën studentët informohen mbi aspektet e ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu planin mësimor, programet lëndore, mënyrën e vlerësimit, etj. Ky fakt u evidentua edhe nga takimet e zhvilluara në institucion me vetë studentët.</p> <p><i>Aneks_42_Nr.2_Organizimi i zgjedhjeve te Keshillit Studentor</i></p> <p><i>Aneks_42_Nr.5_Njihu me Kolegjin Universitar LOGOS</i></p> <p><i>Aneks_42_Nr.6_Financimi i veprimtarive te propozuara nga Keshilli Studentor</i></p> <p><i>Aneks_42_Nr.11_Mjetet e komunikimit të brendshme dhe të jashtme me studentët në Kolegjin Universitar LOGOS</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe</p>	<p>Sipas RVB-së dhe takimeve të zhvilluara në institucion, Përgjegjësi i Departamentit së bashku me pedagogët organizon çdo fillim viti orë të hapura, ku studentët njihen me planin mësimor (syllabuset) dhe veprimtaritë në shërbim të</p>



dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>programit të studimit. Departamenti vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese.</p> <p><i>Aneks_42_Nr.5_Njihuhet me Kolegjin Universitar LOGOS</i></p> <p><i>Aneks_42_Nr.12_Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020</i></p> <p><i>Aneks_43_Nr.5_regjistra themeltare</i></p>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Nga takimi i realizuar me studentët konstatuam se ata informohen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mundësitë e punësimit, si dhe me mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës. Për këtë ekziston edhe zyra përkatëse e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni Logos. Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Alumni, u informua që kjo zyrë orienton studentët drejt tregut të punës. Çdo student që merr pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës duhet të regjistrohet pranë zyrës përkatëse duke ndjekur hapat e përshkruar në Rregulloren mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. (<i>Aneks_12_Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës</i>)</p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Sipas RVB-së, informacion mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij gjendet në faqen zyrtare të institucionit dhe në programet e lëndëve, por paralelisht ju dërgohen informacione gjithsecilit në adresën e tyre të postës elektronike. Gjatë situatës së pandemisë kjo procedurë kryehej online si dhe me materiale informuese për programin e studimit, të cilat publikohen online ose broshura të printuara.</p>			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<p>Sipas deklarimeve gjatë takimit në institucion dhe RVB-së, informacione në lidhje me programin e studimit sigurohen nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, rrjeteve sociale dhe komunikimit me email. Platformat që përdoren janë: TEAMS dhe EDU PAGE. (<i>Aneks_40_Nr.1_Edupage Studentët</i>)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar me punonjëset e sekretarisë mësimore në shërbim të programit të studimit, kryesekretaren e fakultetit dhe administratoren, u informuam se ato administrojnë të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Sekretaria na vuri gjithashtu në dispozicion regjistrin themeltar të notave. <i>(Aneks_43_Nr.1_Statistika - Perfundimet Vjetore dhe Diplomimet e Studentëve)</i></p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet akademike është: Viti Akademik 2018-2019 8 studentë – 4 të cregjistruar; Viti Akademik 2019-2020 2 studentë; Viti Akademik 2020-2021 9 studentë; Totali për një cikël studimi 15 studentë gjithsej.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konfirmua se sekretaria mësimore e fakultetit arkivon në hard copy dhe në format elektronik dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, ose edhe i ç’regjistruar. Të gjitha këto veprime bëhen në mbështetje të dokumenteve të mëposhtëm.</p> <p><i>Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU “LOGOS”</i> <i>Aneks_3_Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor</i> <i>Aneks_43_Nr.1_Statistika - Perfundimet Vjetore dhe Diplomimet e Studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me personelin e sekretarisë mësimore, konstatoi se ato menaxhonin të dhënat e ecurisë së studentëve përgjatë gjithë procesit, nga regjistrimi deri në diplomim. Studenti ka akses informues për gjendjen e rezultateve përmes platformës EduPage.</p> <p><i>Aneks_43_Nr.3_Regjister i notave MAP</i> <i>Aneks_43_Nr.4_Gjenetimi i notave.</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe</p>	<p>Sipas RVB-së, por edhe nga informacioni i marrë gjatë takimit me studentët, rezultatet e studentëve janë të disponueshme në llogarinë individuale të tyre në platformën online EduPage, ku ata kanë akses përmes këtij sistemi të brendshëm. Të dhënat paraqesin regjistrimet, largimet,</p>


lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	transferimet, rezultatet në provimet semestrale për çdo lëndë e student, numrin e krediteve, studentët e diplomuar dhe temën përkatëse të tezës së diplomës			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në rastin e programit të Gjuhës dhe Civilizimit Grek, sekretaria nuk ka raporte analitike mbi daljen e studentëve pasi ky është viti i pare akademik që pritet të ketë përyllje të ciklit studimor dhe ndaj nuk ekzistojnë momentalisht raporte analitike periodike të këtij kriteri.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në bazë të statutit të institucionit, akteve ligjore dhe rregullores së KU LOGOS, studentët përfaqësohen në organet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Senat Akademik; - Komisioni i përheshëm; - Këshilli i Etikës; <p><i>Aneks_3_Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, Neni 121;</i> <i>Aneks_42_Nr.1_Rregullore e Keshillit Studentor.</i> <i>Aneks_42_Nr.3_Statuti i Keshillit Studentor</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin	Sipas statutit studentët janë pjesë e vendimmarrjes në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Gjithashtu, gjatë takimit të zhvilluar me studentët, u deklarua nga ana e tyre se përfaqësimi i tyre në organet e ndryshme të institucionit kishte efekte e pozitive në

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>proceset e vendimmarrjes që lidheshin me ta. Në Grupin e punës ngritur nga NJSBC për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këtë program studimi, është përfshirë një përfaqësues i qeverisë studentore, student i këtij programi.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni respekton ngarkesën akademike sipas parashikimeve ligjore duke ofruar një program me kohë të plotë të përbërë prej 60 kreditesh. Sipas përshkrimit nga Dekani i institucionit studenti ngarkohet me 600 orë në auditor dhe 900 orë me punë të pavarur për çdo vit akademik.</p> <p><i>Aneks_14_Nr.1_Plani_mesimor_2020_2021.</i></p> <p><i>Aneks_14_Nr.2_Plani_mesimor_2019_2020</i></p> <p><i>Aneks_14_Nr.3_Plani_mesimor_2018_2019</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët kanë përfaqësimin e tyre në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, dhe janë pjesëmarrës në Komisionin për Vlerësimin Institucional. Në këtë mënyrë, ata bëhen pjesën e vendimmarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri.</p> <p><i>Aneks_22_Nr.14_Propozimet_e_studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas informacioneve të marra nga takimi i GVJ me studentët, organizohet dhe zhvillohet një pyetësor me studentët e programit të gjuhës dhe civilizimit grek, i cili mundëson vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ. Konstatohet se të dhënat e mbledhura nga plotësimi i pyetësorit të studentëve paraqesin idetë dhe mendimet e tyre për cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor (leksione+ seminare) por dhe për kompetencën profesionale të pedagogëve.</p> <p><i>Aneks_30_Nr.4_Rezultatet_e_vleresimit_(anonim)</i></p> <p><i>Aneks_2_Rregullorja_e_përgjithshme_e_KU_“LOGOSNeni_100-101.”</i></p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Rezulton se institucioni përdor procedura për informimin e studentëve nëpërmjet zyrave përkatëse, p.sh. sekretaria mësimore. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, bashkëpunon me Njësinë Kryesore dhe atë bazë informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët, u vlerësua nga ana e tyre java e parë orientuese për informimin e tyre. <i>Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS"</i> <i>Aneks_19_Nr.6_Vendim për Pedagogët Kujdestarë</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në shërbim të studentëve dhe të programit të studimit, funksionon Zyra e çështjeve të studentëve, e cila është përgjegjëse për krijimin e programit të mentorimit në mbështetje të orientimit profesional të studentëve. Sistemi që ofrohet është ai EduPage nga ku mund të marrin një gamë të gjerë informacionesh mbi çështje që lidhen me procesin mësimor, dhe programin e studimit. <i>Aneks_42_Nr.12_Aktivitetet për vitet akademike 2017-2020</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të	Institucioni disponon Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Zyrën e Çështjeve të studentit ku në mënyrë periodike ju ofrojnë atyre këshillim si nga ashtu edhe on line, duke ju përcjellë çdo informacion relevant në lidhje me kompletimin e procesit mësimor. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione private dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti, por situata e pandemisë e ka kushëtzuar këtë proces, i cili është zhvilluar dhe online. <i>Aneks_42_Nr.14_Politika e Marketingu te programit te studimit_Format e tij_Transparenca me publikun</i> <i>Aneks_42_Nr.15_Analiza e punesimit te studenteve te diplomuar</i>



tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, na u konfirmua se ekzistojnë të dhëna statistikore për të gjithë studentët deri në stadin ekzistues, pra në vitin e tretë, por meqenëse programi i Gjuhës dhe i Civilizimit Grek është i ri, këtë vit do të mbahen të dhënat statistikore mbi zhvillimet profesionale që do të shënojnë të diplomuarit. Në parim KU LOGOS disponon pasqyrë të plotë të të dhënave mbi zhvillimet të degëve të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Kuadri ligjor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel insitucional është i mirëorganizuar. NJSBC është themeluar për të vlerësuar në trajta periodike efikasitetin e procesit mësimor, administrativ e financiar të KU LOGOS. Njësia e Sigurimit të Kontrollit të Brendshëm së bashku me Komisionin e Përheshëm të Vlerësimit Institucional hartojnë politikat e sigurimit të cilësisë në koordinim me Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. <i>Aneks_1_ Statuti i KU "LOGOS", neni 43, 44.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të	Sipas drejtuesëve të këtij Institucioni mbetet përparësi e veçantë ruajta e nivelit të lartë të cilësisë. Përmbushja e kriterëve për mbajtjen e vazhdueshme të cilësisë ka vënë në

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>mobilizim një sërë hallkash si në rang studentësh ashtu edhe pedagogësh që ndërveprojnë për ruajtjen e ekuilibrave të cilësisë duke u marrë mendimi i tyre nga anketimi që zhvillohen gjatë vitit akademik dhe duke ndërhyrë me masa plotësuese që moderojnë pikërisht ato pjesë që konsiderohen të nevojshme. ASCAL është një tjetër aktor që ndikon në monitorimin e cilësisë konform procedurave ligjore që ndjek.</p> <p><i>Aneks_5_Plani Strategjik i zhvillimit të KU "LOGOS", 2018-2024</i></p> <p><i>Aneks_38_Nr.1_Rregullore per sigurimin e cilesise neni 25-26.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë duke përdur anketime e formularë për monitorimin e gjendjes aktuale dhe duke përcjellë infomacionin në autoritetet përgjegjëse të cilat propozojnë instrumentat për përmirësimin e çdo eventualiteti. NJSBC përdor disa instrumenta për vlerësimin periodik të mësimdhënies, mësimnxënies, veprimtarive kërkimore dhe shërbimeve për mbështetjen e studentëve si: vlerësimet për performancën e stafit akademik, dhe pyetësi i studentëve për matjen e cilësisë së mësimdhënies. Të dhënat grumbullohen, përpunohen nga NJSBC dhe bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit.</p> <p><i>Aneks_38_Nr.1_Rregullore per sigurimin e cilesise neni 24-25-26.-28</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ndjek procedura periodike që krijojnë kulturën e ruajtjes së cilësisë nga të gjithë faktorët ndërveprues, duke sjellë në vetvete një shkallë përmirësimi të vazhdueshme.</p> <p><i>Aneks_38_Nr.4_Politika për sigurimin e cilësisë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Institucioni disponon Komisionin e Përhershëm për garantimin e cilësisë dhe Njësinë e Sigurisë së Brendshme të Cilësisë të cilat bëjnë raporte periodike dhe rishikojnë programet e ciklit të parë. GVJ referuar takimeve në institucion konstaton se NJSBC monitoron, rishikon dhe kontrollon ecurinë e programit të studimit. Pjesë e këtij procesi janë pyetsorët e realizuar nga njësia për stafin akademik dhe studentët, ku rezultatet e këtij procesi i komunikohen autoriteteve përgjegjëse dhe vednimarrëse për programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni formon grupe pune kur sheh të arsyeshme ndryshimin e kurrikulës nën masën 20%. Rezulton se hartohet çdo vit akademik Raporti Vjetor në rang institucioni dhe i Departamentit, ku paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit bachelor. <i>Aneks_49_Procedure ndryshimi te kurrikules</i> <i>Raporti Vjetor i Departamentit GJCG (2019-2020)</i> <i>Aneks_35_Nr.2_Raporti Vjetor 2019-2020 i KU "LOGOS", Monitirimi i sigurisë dhe cilesisë</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	U konstatua se ekzistojnë instrumentet matëse dhe vlerësuese dhe ato janë raportet vjetore që përgatit NJSBC në bashkërendim me departamentin e Gjuhës dhe Civilizimit grek me synim përmirësimin e cilësisë. Gjithashtu për matjen e cilësisë Kolegji përdor edhe pyetsorin e studentit me qëllim matjen e cilësisë së zbatimit të programit. <i>Aneks_23_Nr.2_Proces-verbal takimi (student);</i> <i>Aneks_38_Nr.2_Proces-Verbal i Asamblese Nr. 1 të Fakultetit;</i> <i>Aneks_34_Seminar Zhvillimi Personel Akademik.;</i> <i>Shih Aneksin 38, Nr. 2, Aneksin 23, Nr.1 dhe Aneksin 34.</i>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe	Rezultatet përcillen përherë te drejtuesit e Departamentit, për të bërë ndryshimet përkatëse. Pas shqyrtimit të procedurës për analizën e vlerësimit të pyetësorit të studentëve rezulton se të

vendimmarrëse për programin e studimit.	dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. <i>Aneks_38_Nr.3_Proces-Verbali i Takimit Nr. 3</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe funksionojnë si instrumente matëse dhe krahasuese për hartimin e strategjive në funksionin të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni harton cdo vit raportin vjetor, ku analizon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Në referencë të përshkrimit të dokumentit (<i>Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS, Neni 128</i>) dhe (<i>Aneks_21_Raporti Vjetor i Departamentit GJCG (2019-2020)</i>), mund të thuhet se menaxhohet cilësia e programit që ofrohet me anë të: - hartimit të Raportit vjetor të veprimtarisë së departamentit; - hartimit të Relacionit për vlerësimin periodik të programit të studimit nga NJSBC-ja; NJSBC gjithashtu kryen edhe vlerësime të brendshme të programeve të studimit, monitoron rregullisht realizimin e programit dhe rezultatet e arritura në procesin mësimor.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Konstatohet se institucioni përdor instrumentat e përshtatshëm për kontrollin e kryerjes së vlerësimit konform metodologjisë të dok (<i>Aneks_38_Nr.8_Paketa e Instrumenteve të NJSBC_2018-19</i>), ku Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sipas dok (<i>Aneks_38_Nr.1_Rregullore për sigurimin e cilesise</i>), ngre grupe pune dhe monitoron përmes sondazheve, anketimeve dhe intervistave me personelin akademik dhe me studentët



	duke hartuar raporte periodike dhe vjetore mbi zhvillimin e ecurisë së KU LOGOS në përputhje me standardet e synuara.			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, u konstatua se përsa i përket vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit studimor, vlerësimeve të provimeve, detyrave të studentëve etj., kryhen një sërë anketimesh me karakter vlerësues të treguesëve të kërkuar sipas dok (<i>Aneks_38_Nr.1_Rregullore per sigurimin e cilesise</i>), dhe u vu re gjatë intervistimeve që GVJ pati me studentët e pedagogët se plotësonin raporte vjetore vlerësuese mbi aktivitetin e Administratës, të Pedagogëve, të studentëve të cilat funksionojnë në formatin e vlerësimeve të drejtpërdrejta dhe vërehet se si ecuria e funksionimit bashkëudhëton me Planin Strategjik të KU LOGOS.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Në lidhje me këtë kriter Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek duke qenë se nuk ka ende të diplomuar, vlerësimi i Alumni nuk mund të aplikohet, por zhvillohen raportet e monitorimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë të aktivitetit të personelit akademik në lidhje me programin e studimit dhe me cilësinë e didaktikës dhe të transmetimit të dijes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni lidhur me këtë kriter ka hartuar një sërë politikash lidhur me procedurat e brendshme të cilësisë dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm e të brendshëm. Politikat e garantimit të cilësisë funksionojnë sipas dok. <i>(Aneks_38_Nr.4_Politika për sigurimin e cilësisë); (Aneks_38_Nr.8_Paketa e Instrumenteve te NJSBC_2018-19); (Aneks_2_Rregullorja e përgjithshme e KU "LOGOS" pika 127-129).</i></p> <p>Ato janë në mbështetje dhe të dokumenteve themelore, institucionale, si: Statuti dhe Rregullore Fakulteti. Dokumentet e mësipërme orientojnë dhe paraqesin detyra dhe përgjegjësi të përfshirjes në procese të vetëvlerësimit të njësisë bazë, të personelit dhe për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe ale të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, Institucion përfshin rolin e individëve, të studentëve dhe të pëlëve të tjera pasi vazhdimisht mbetet i interesuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe këtë e arrin përmes angazhimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe mënyrës së funksionimit të kësaj njësie në kombinim me administratën dhe hierarkinë drejtuese, duke aplikuar taktikat më të mira për përmbushjen e Planit Strategjit të KU LOGOS. <i>(Aneks_38_Nr.5_Vendime mbi perberjen e NJSBC (2011, 2018, 2020) te Kolegjit Universitar LOGOS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se institucioni garanton përfshirjet e njësisë bazë, njësisë kryesore, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe të studentëve dhe kjo duket dhe evidentohet nga GVJ sipas dok <i>(Aneks_50_Proces verbali i Takimit Nr.4 (24.03.2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo</p>	<p>Institucioni në bazë të rregullores dhe sipas konstatimeve në takim me pedagogët, adminstratën dhe studentët nuk lejon ekzistencën dhe përfshirjen e personelit të tij qoftë të administratës ose të personelit akademik ose të studentëve në shfaqje trajtash të çfarëdoshme diskriminuese, anshmërie ose</p>






Iloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	pabarazie. Ky kriter përfshihet edhe në rregulloren e KU LOGOS.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ky kriter përmbushet pasi kontakti i KU LOGOS në programin e Gjuhës dhe Civilizimit Grek me Universitetin e Greqisë si ai i Thessalonikës, ai i Thracës, ai i Pireut me prurjet e pedagogëve të jashtëm që përfshihen në këtë departament ofrojnë ekspertizë dhe mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit pasi janë drejtpërdrejtë të përfshirë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sikundërse kemi përmendur edhe më lart, KU LOGOS monitoron vazhdimisht dhe periodikisht raportin e ruajtjes së cilësisë përmes instrumenteve të shumtë, dhe publikon fletëpalosje, broshura, përgatit raporte vlerësimi të cilat shprehen dhe gjenden në faqen zyrtare të internetit http://kulogos.edu.al/al/list-of-accreditations.html duke ruajtur nivelet e transparencës.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konstatohet se institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit në faqen e tij zyrtare të internetit: http://kulogos.edu.al/al/list-of-accreditations.html dhe vepron në respekt të legjislacionit mbi të dhënat personale. <i>(Aneks_38_Nr.1_Rregullore per sigurimin e cilesise.);</i> <i>(Aneks_38_Nr.4_Politika per sigurimin e cilesise)</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Nga vizita në institucion u konstatua gjatë intervistave me pedagogët se ndiqet një plan masash mbi rezultatet e

masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	vlerësimeve duke i përpunuar vlerësimet në dobi të ruajtjes të cilësisë së shprehur në statut dhe duke shënuar hapa konkret së bashku me organet drejtuese që administrojnë çështje të progresit të KU LOGOS.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni në mënyrë periodike monitoron veprimtaritë e tij në lidhje me programet e studimeve dhe vlerësimin e cilësisë me synim të vazhdueshëm ruajtjen e cilësisë dhe ngritjen e saj për cdo program studimi.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni zhvillon veprimtari periodike përmesh sondazheve, anketave, plotësimit të formularëve të kontrollit, fushatave informuese për të sensibilizuar dhe për të ndërgjegjësuar personelin akademik dhe vetë studentët mbi rëndësinë e sigurimit të përmirësimin afatgjatë të cilësisë për programet e studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë dhe Civilizim Grek”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura përmbush të gjitha nevojat e studentëve, me laboratorë, bibliotekë, salla leksionesh e seminaresh, pajisje, burimet e literaturës;
2. Stafi me përvojë të gjatë akademike në mësimdhënie edhe në kërkim shkencor si brenda dhe jashtë vendit;
3. Korniza kurrikulare e përkthyer me qasje kombëtare dhe ndërkombetare;
4. Nxitja e mendimit të pavarur të studentëve;
5. Siguria financimit të programit të studimit nga fondacioni përkatës;

b. Pika të dobta:

1. Programi i studimit “Gjuhë dhe Civilizim Grek”, për momentin nuk ka vazhdimësi në ciklin e dytë;
2. Informacioni që lexohej në RVB shpesh ishte jo shumë i qartë. Kishte përsëritje dhe nuk kishin evidentuar pikat e forta të këtij programi. RVB mund të kishte cilësuar më mirë shërbimet e ofruara;
3. Sipas kërkesave ligjore në përputhshmëri me VKM nr. 418 datë 10.05.2017, dhe referuar RVB-së dhe informacionit të ngarkuar është konstatuar nevoja e një stafi akademik efektiv për të mbuluar jo më pak se 70% të ngarkesës së orëve në auditor;

Rekomandime:

1. Lidhur me programin bachelor “Gjuhë dhe Civilizim Grek”, GVJ rekomandon: Krijimi, i një programi të përbashkët me një nga departamentet e univeristeteve me të cilët, KU LOGOS bashkëpunon, si p.sh. “Demokritos”, “Aristotelis”. Ky program i përbashkët do të ndihmonte që studentët të fitojnë një diplomë evropiane;
2. Referuar programit të studimit dhe praktikave profesionale të zhvilluara në shkollat AMU dhe AML të Fondacionit “Frymë Dashurie”, mendojmë se është e nevojshme edhe përfshirja e temave të fushës të mësuesisë në punimet e diplomës;
3. Krijimi i një bankë pyetjesh për provimin përfundimtar të diplomës do të ndihmonte në plotësimin e strukture së vlerësimit edhe për studentët që nuk arrijnë mesataren e lartë për të fituar të drejtën për një punim diplome;
4. Është e nevojshme që institucioni të marrë masa për të shtuar numrin e stafit akademik efektiv që të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës së orëve në auditor, sipas kërkesave ligjore në përputhshmëri me VKM nr. 418 datë 10.05.2017;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Greek Language and Civilization"

a. Strong points and affirmations:


1. Infrastructure meets all the needs of students, with laboratories, library, lecture and seminar rooms, equipment, literature resources;
2. Staff with long academic experience in teaching and research both at home and abroad;
3. Translated curricular framework with national and international approach;
4. Promoting students' independent thinking;
5. Security of financing the study program from the respective foundation;

b. Weaknesses:

1. The study program "Greek Language and Civilization", at the moment there is no continuity in the second cycle;
2. The information read in the Internal Evaluating Raport (RVB) was often not very clear. There were recurrences and they had not identified strengths of this program. Internal Evaluating Raport (RVB) could have better rated the services provided;
3. According to legal requirements in accordance with DCM (Decision of the Coouncil of Ministers) no. 418 dated 10.05.2017, and referring to the Internal Evaluating Raport (RVB) and the information uploaded, was ascertained the need for an effective academic staff to cover not less than 70% of the workload in the auditorium;

Recommendations:

1. Regarding the bachelor program "Greek Language and Civilization", EEG recommends: The establishment of a joint program with one of the departments of universities with which, KU LOGOS cooperates, such as. Democritus, Aristotle. This joint program would help students earn a European degree;
2. Referring to the study program and professional practices developed in the AMU and AML schools of the "Frymë Dashurie" Foundation, we think that it is necessary to include topics in the field of teaching in the diploma thesis;
3. The creation of a question bank for the final diploma exam would help complete the assessment structure even for students who do not reach the upper average to earn the right to a diploma thesis;
4. It is necessary for the institution to take measures to increase the number of effective academic staff to cover not less than 70% of the working hours in the auditorium, according to legal requirements in accordance with DCM no. 418 dated 10.05.2017;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

